

**PROGRAMI I TRAJNIMIT
TË PARALIGJORËVE**

Nocioni i paraligjorit, kuadri ligjor dhe funksionet e tij në dobi të komunitetit

TETOR 2022



Centre for Legal
Empowerment

www.cle.al

Çështjet që do të shtrohen përgjatë trajnimit

1. Çnënkuptojmë me **termin** paraligjor?
2. Cilat janë **detyrat kryesore** të një paraligjori?
3. Cilat janë **elementët që duhet të zotërojë** një paraligjor?
4. Ku ndryshon **profesioni i paraligjorit nga profesionet e tjera** si asistent ligjor; aktivist apo ofrues i shërbimit të ndihmës juridike parësore?
5. Rregullimi i profesionit të paraligjorëve, **eksperienca e shteteve të huaja**.
6. Inicativa për **përfshirjen e paraligjorit si një profesion i rregulluar** në RSH.

Çnënkuptojmë me termin paraligjor?

Paraligjori

Në kushtet kur profesioni i paraligjorit nuk është një profesion i rregulluar me ligj, nuk kemi një përkufizim mbi termin paraligjor. Nga praktika, paraligjor konsiderojmë:

- Një person i cili ka njohuri të përgjithshme në fushën e drejtësisë, që ofron shërbime të ndihmës juridike parësore për çështje të thjeshta dhe **orienton mbi të drejtat e qyetarëve** dhe shkeljet e mundshme të tyre.
- Profesionisti që **lidh marrëdhënien midis familjes/individit dhe avokatit** për një problematikë ligjore dhe mban kontakte të vazhdueshme me familjen/individin, si dhe mbledh informacionin e nevojshëm që mund ti shërbejë avokatit për ndjekjen e çështjes.
- Individ që **punën e tij e ushtron në terren** dhe kanalizon dhe përcjell problematikat e hasura në komunitet pranë institucioneve përgjegjëse.
- Urë **lidhëse midis komunitetit dhe punës në zyrë.**
- Personi që bën organizimin komunitar në komunitetin e tij nëpërmjet njohurive ligjore. Mesazhi i paraligjorit duhet të jetë **“Ne do ta zgjidhim problemin bashkë”**.

Cilat janë detyrat kryesore të një paraligjori?

Ndërgjegjësimi dhe edukimi ligjor i komunitetit/Fuqizimi ligjor

Shoqërimi para institucioneve shtetërore dhe përfaqësimi pranë tyre.

Organizator komunitar, tranferon njohuri ligjore dhe advokon për të zgjidhur problemet

Identifikimi i problematikave ligjore dhe çështje që prekin një komunitet

Këshillim ligjor bazik, hartim i shkresave, përpilim i dokumentave për të vënë në lëvizje institucionet

Referimi i rasteve pranë ofruesve të ndihmës juridike parësore dhe dytësore/Informim mbi ndihmën juridike falas.

Cilat janë detyrat kryesore të një paraligjori?

Identifikimi i problematikave ligjore që pengojnë aksesin


Dhënia e informacionit mbi zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve dhe prirja për aftësi bashkëpunuese me autoritetet vendore/qendrore/të pavarura

Në aspektin social, paraligjori luan rolin e menaxhuesit optimal të stresit të qytetarit, përballimin emocional dhe referimin e zgjidhjeve të duhura.

Cilat janë elementët që duhet të zotërojnë një paraligjor?



Cilat janë elementët që duhet të zotërojnë një paraligjor?



Ku ndryshon profesioni i paraligjorit nga profesionat e tjera si asistent ligjor; aktivist apo ofrues i shërbimit të ndihmës juridike parësore?

Aktivisti

- Aktivizmi konsiston në përpjekjet për të nxitur, penguar, drejtuar ose ndërhyrë në reforma shoqërore, politike, ose ekonomike me dëshirën për të bërë ndryshime në shoqëri.
- Një aktivist është një person që punon për të ndryshuar një komunitet, duke synuar ta bëjë atë një vend më të mirë.
- **Aktivistët, ndryshe nga paraligjorët** rastin e identifikuar e referojnë tek profesionistët, duke mos patur dijeni mbi mënyrën se si zgjidhet ky rast.

Asistenti Ligjor

- Asistenti Ligjor është një profesion, që merret kryesisht me përgatitjen e dokumentacionit, praktikave për çështje të ndryshme, kërkesave institucionale, studimin e legjislacionit, gjetjen dhe mbledhjen dhe sistemin e dokumentacionit, përgatitjen e opinionëve ligjore me çështje të caktuara si dhe veprimtari të tjera administrative.
- **Asistentët ligjorë, ndryshe nga paraligjorët** ndjekin vetëm procedurën ligjore, duke harruar shpesh herë pjesën njerëzore dhe kontaktin me individin.
- **Profesioni i paraligjorit, ndryshe nga asistentët ligjorë** nuk ushtrohet domosdoshmërisht vetëm nga juristët por edhe nga punonjësit social, psikologët etj.

Ofruesi i ndihmës juridike parësore

- Detyrat e paraligjorëve janë shumë të ngjashme me ato të ofruesve të ndihmës juridike parësore. **Dallimi qëndron tek lidhja e ngushtë që ka paraligjori me komunitetin.**
- Ofruesit e ndihmës juridike parësore janë të vendosur pranë zyrave, duke mos patur mundësi të vëzhgojnë problematikat në terren;
- Rasti i identifikuar nga paraligjori, në rast se është më kompleks referohet pranë ofruesit të ndihmës juridike parësore.

Rregullimi i profesionit të paraligjorëve, eksperiencia e shteteve të huaja

• *Praktikat më të mira të kuadrit ligjor në Sierra Leone, Afrikë e Jugut dhe Moldavi të cilat e kanë të rregulluar ligjërisht profesionin e paraligjorit.*

- **Paraligjorët në Sierra Leone:**

- ❑ Ligji i vitit 2012, për ndihmën juridike parashikon ngritjen e **Bordit të Ndihmës Juridike**, strukturë mbikëqyrëse në formën e një organizate jofitimprurëse e cila akrediton ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike dhe administron ofrimin e këtij shërbimi.
- ❑ Sipas këtij ligji, një **“Paraligjor i akredituar”** është një **person i punësuar** nga Bordi, një department qeveritar, një organizatë e akredituar e shoqërisë civile, ose një OJQ, dhe **që ka përfunduar një kurs trajnimi** në fushën përkatëse të studimit në Institutin e Trajnimit Gjyqësor dhe ligjor ose në një institucion arsimor të miratuar nga Bordi.
- ❑ Bordi i Ndihmës Juridike cakton **të paktën 1 (një) paraligjor çdo komunë** me qëllim rritjen e qasjes në drejtësi veçanërisht në komunitetet e largëta.
- ❑ Paraligjorët e Bordit, përveç punës në komunitet monitorojnë shtëpitë e fëmijëve dhe stacionet policore, kujdesit shëndetësor, paraburgimit **me qëllim që të përcaktojnë nevojat e tyre ligjore.**

Rregullimi i profesionit të paraligjorëve, eksperiencia e shteteve të huaja

• Praktikant më të mira të kuadrit ligjor në Sierra Leone, Afrikë e Jugut dhe Moldavi të cilat e kanë të rregulluar ligjërisht profesionin e paraligjorit.

- Mjetet dhe strategjitë e paraligjorëve për zgjidhjen e problemeve ligjore në Sierra Leone:

Dhënia e informacionit

Aksesi tek autoritetet

Ndërmjetësimi

Advokimi dhe edukimi i komunitetit (Dhuna në familje)

Organizimi i veprimeve kolektive (ndërtimi i një rruge)

Asistimi në procedurat gjyqësore (dosja, kërkime ligjore, dëshmitarë, prova)

Rregullimi i profesionit të paralogjorëve, eksperiencia e shteteve të huaja

- *Praktikat më të mira të kuadrit ligjor në Sierra Leone, Afrikë e Jugut dhe Moldavi të cilat e kanë të rregulluar ligjërisht profesionin e paralogjorit.*

- **Sistemi i Klinikave të Lëvizshme (mobile)**

Ky system është shumë i domosdoshëm për të patur akses tek zonat e largëta të Sierra Leones.

Paralogjorët vizitojnë një grup fshatrash pranë çdo zyre 4 (katër) të Premte në muaj. Të njëjtat fshatra frekuentohen çdo muaj në mënyrë që banorët të presi që paralogjorët të vijnë periodikisht në datat e dakordësuara. Një person kontakti në çdo fshat shërben si ndërlidhës mes paralogjorit dhe kanëtarëve të komunitetit në kuadër të sigurimit të një vendi për të mbajtur seancat; njoftimin e anëtarëve të komunitetit etj.

Rregullimi i profesionit të paraligjorëve, eksperiencia e shteteve të huaja

- *Praktikat më të mira të kuadrit ligjor në Sierra Leone, Afrikë e Jugut dhe Moldavi të cilat e kanë të rregulluar ligjërisht profesionin e paraligjorit.*

- **Paraligjorët në Afrikën e Jugut**

- Afrika e Jugut ka krijuar Institutin Kombëtar të Paraligjorit. Paraligjori ofron ndihmës juridike bazike dhe asistencë nën mbikëqyrjen e një praktikuesi ligjor.
- Në Dhjetor të vitit 2014, u miratua ligji i ri për ndimën juridike në Afrikën e Jugut i cili autorizon si ofrues shërbimi praktikuesit ligjore, avokatët, kandidatët për avokatë dhe paraligjorët.
- Paraligjorët ndjekin trajnimin zyrtar për këtë profesion të ofruar nga disa universitete dhe institute që përfshijnë njohur mbi procesin gjyqësor, shkrimin ligjor, të drejtën familjare, të drejtën e punës, pasuritë e paluajtshme etj.

Rregullimi i profesionit të paraligjorëve, eksperiencia e shteteve të huaja

• *Praktikat më të mira të kuadrit ligjor në Sierra Leone, Afrikë e Jugut dhe Moldavi të cilat e kanë të rregulluar ligjërisht profesionin e paraligjorit.*

- **Paraligjorët në Moldavi:**

- ❑ **Ligji i vitit 2007, për ndihmën juridike garantoj për herë të parë një përcaktim të konceptit “Paraligjor”, si një person që respektohet nga komuniteti lokal, me studime juridike jo të plota të arsimit të lartë i cili nuk ushtron profesionin e avokatit por i është nënshtruar një trajnimi të posaçëm sipas rregullores për statusin dhe kualifikimin e paraligjorëve.**
- ❑ **Në Shkurt të vitit 2018, profesioni i paraligjorit u përfshi në Klasifikuesin e Profesioneve në Republikën e Moldavisë, hap i rëndësishëm në institucionalizimin e paraligjorit.**
- ❑ **Në vitin 2019, ishin 62 pozicione paraligjori të parashikuara në skemën e Këshillit Kombëtar të Ndhmës Juridike me 58 paraligjorë që financohen nga buxheti i shtetit. Një paraligjor është i caktuar në një komunitet apo fshat të caktuar.**

Inicativa për përfshirjen e paraligjorit si një profesion i rregulluar në RSH

- ❑ VKM nr. 514, datë 20.09.2017, “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve”, i rishikuar nuk e ka të parashikuar “Paraligjorin” në Listën Kombëtare të Profesioneve. Nevojitet **ndërmarrja e propozimeve për ndryshimin e VKM nr. 514/2017**, me qëllim shtimin e profesionit të paraligjorit në grupin njësi 3412 “Asistentë, specialist të punës sociale”.
- ❑ Ligji nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, nuk e ka të parashikuar paraligjorin ndër ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike. Nevojitet **ndërmarrja e propozimeve për ndryshimin e Ligjit nr. 111/2017**, me qëllim përfshirjen e paraligjorit në skemën e ndihmës juridike të garantuar nga shteti dhe mbështetjen financiare të tyre me fonde të buxhetit të shtetit.
- ❑ Formalizimi i **trajnimeve të detyrueshme për paraligjorët** të ofruara nga institucione të akredituara për këtë qëllim, përpos ndjekjes së trajnimeve të vazhdueshme dhe specializimeve nga OJF-të apo Universitetet.
- ❑ Vendosja e **të paktën 1 (një) paraligjori në çdo Bashki**, i cili të zhvillojë vizita periodike në fshtatrat e njësive administrative që Bashkia respektive mbulon (praktika e Sierra Leones)
- ❑ Kontraktimi i **paraligjorëve të specializuar në fusha përkatëse** (Romët dhe Egjiptianët; LGTBIQ etj.)

Baza për përgatitjen e materialit:

- ❑ Analizë e legjislacionit shqiptar për rolin e paraligjorit dhe vlerësimi i ekzistencës së kushteve për përfshirjen e këtij profesioni në listën kombëtare të profesioneve- Av. I.Aliaj, Av. E.Meli, financuar nga Fondacioni “Shoqëria e Hapur për Shqipërinë”, Tetor 2020;
- ❑ Ligji nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”;
- ❑ VKM nr. 514, datë 20.09.2017, “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve”, i rishikuar.

JU FALEMINDERIT!

**PROGRAMI I TRAJNIMIT
TË PARALIGJORËVE**

***Aksesi në Drejtësi dhe risitë e ligjit nr.111/2017,
“Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”***

TETOR 2022



Centre for Legal
Empowerment

www.cle.al

Aksesi në drejtësi si një e drejtë themelore Kushtetuese dhe Konventore

Aksesi në drejtësi shihet si mundësia efektive e njerëzve për të arritur zgjidhje përmes institucioneve të drejtësisë

•Kuadri Ligjor Ndërkombëtar:

✓ **Neni 6 i KEDNJ:** “Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtë të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij. Në qoftëse ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t’i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë”

✓ **GJEDNJ: Delcourt kundër Belgjikës,** (17 Janar 1970), “Në një shoqëri demokratike brenda kuptimit të Konventës, e drejta për një ushtrim të drejtë të drejtësisë zë një vend kaq të rëndësishëm, sa një interpretim i kufizuar i nenit 6 të KEDNJ që garanton të drejtën për një proces të drejtë dhe të hapur ligjor, nuk do t’i korrespondojë synimit dhe qëllimit të kësaj dispozite”.

✓ - **GJEDNJ: Airey kundër Irlandës,** “E drejta për një gjykim të drejtë mund të përfshijë një të drejtë të nënkuptuar për ndihmë juridike në çështjet civile nëse është e domosdosme për një qasje efektive në drejtësi, në varësi të rëndësisë, kompleksitetit të çështjes dhe aftësive të kërkuarit për të përfaqësuar vetë veten e tij”

Aksesi në drejtësi si një e drejtë themelore Kushtetuese dhe Konventore

•Kuadri Ligjor Ndërkombëtar:

- ✓ Për të shmangur arbitraritetin, një sistem i ndihmës juridike duhet të krijojë një **mekanizëm të drejtë** për përzgjedhjen e çështjeve që mund të përftojnë (*Gnavoré kundër Francës*). U takon shteteve të krijojnë sisteme që të përputhen me KEDNJ-në. Mosmarrja e një vendimi zyrtar mbi një kërkesë për ndihmë juridike përbën shkelje.
- ✓ Qëndrimi i GJEDNJ është gjetur sinkron me jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese (VGJK nr. 7/2013), e cila e ka konsideruar **ndihmën juridike të garantuar nga shteti si një pjesë themelore e të drejtës për një proces të rregullt ligjor**.
- ✓ Detyrimi për të garantuar të drejtën efektive të aksesit në gjykatë nuk nënkupton thjesht mungesën e një ndërhyrjeje, “*por mund të kërkojë edhe ndërmarrjen e veprimeve pozitive nga ana e shtetit*”.
- ✓ Në rast se mohohet një e drejtë e tillë, procesi konsiderohet jo i rregullt, sepse aksesit në gjykatë është para së gjithash një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera. **Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t’iu drejtuar gjykatës.**

Aksesi në drejtësi si një e drejtë themelore Kushtetuese dhe Konventore

•Kuadri Ligjor European

•**Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian, neni 47:** “çdo person të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara nga e drejta e BE, ka të drejtën të paraqesë një mjet ligjor të efektshëm më një gjykatë sipas kushteve të përcaktuara në këtë nen. **Personave të cilëve nuk kanë mjete të mjaftueshme u jepet ndihmë juridike në masën që kjo ndihmë është e nevojshme për të garantuar në mënyrë të efektshme aksesin në drejtësi**”.

•**GJED (C-279/09):** Në bërjen e vlerësimit për dhënien ose jo të ndihmës juridike, gjykata duhet të marrë parasysh:

1. përmbajtjen e- gjykimit;
2. nëse kërkuesi ka një perspektivë të arsyeshme suksesi;
3. rëndësinë e asaj që diskutohet për kërkuenin në gjykim;
4. kompleksitetin e ligjit dhe procedurës përkatëse; dhe
5. aftësinë e kërkuetit për të përfaqësuar veten në mënyrë efektive.

Aksesi në drejtësi si një e drejtë themelore Kushtetuese dhe Konventore

•Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë:

Neni 42/2: . Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

Neni 31/ç: Gjatë procesit penal kushdo ka të drejtë: të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij; të komunikojë lirisht dhe privatisht me të, si dhe t'i sigurohet mbrojtja falas, kur nuk ka mjete të mjaftueshme

1. Vendimi nr.7, datë 27.02.2013 i Gjykatës Kushtetuese
2. Vendimi nr.84, datë 30.12.2016; nr.67, datë 17.11.2015, nr. 65, datë 16.10.2017, i Gjykatës Kushtetuese
3. Vendimi nr. 35, datë 01.06.2015; nr.71, datë 30.11.2016, i Gjykatës Kushtetuese.

• Kodi i Procedurës Civile (Neni 105/b);

- **Kodi i Procedurës Penale (Neni 34/a)**, “I pandehuri ka të drejtë të të ketë një mbrojtës të siguruar nga shteti, nëse mbrojtja është e detyrueshme ose nuk ka mundësi financiare për të pasur një mbrojtës, sipas parashikimeve të këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi për ndihmë juridike;

Vështrim historik i sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti

•Kuadri Ligjor:

- Ligji nr. **10039**, datë **12.2008**, "Për ndihmën juridike".
- Organi kompetent për dhënien e ndihmës juridike - **Komisioni Shtetëror për Ndhmën Juridike (KSHNJ)**;
- Organ kolegjal shtetëror i përbërë nga 5 anëtarë.

•Ndhma Juridike Parësore

- Ndhma juridike parësore dhe dytësore ofrohej nga avokatët sipas një liste të përcaktuar nga KSHNJ, në bashkëpunim me -
- Dhomen Kombëtare të Avokatisë (DhASh);
- Vendimi për pranimin / refuzimin e kërkesës për ndihmë juridike parësore **ishte në diskrecion të Kryetarit të KSHNJ (përmes një akti administrativ).**

•Ndhma Juridike Dytësore

- Vendimi për pranimin / refuzimin e kërkesës për ndihmë juridike dytësore **ishte në diskrecion të Kryetarit të KSHNJ (përmes një akti administrativ).**
- Për këtë vit në listën e avokatëve të KSHNJ **rezultojnë 23 avokatë.**

Siç shihet, nuk kemi një ndarje të qartë midis ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe dytësore.

Vështrim historik i sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti

• **Problematikat e konstatuara:**

1. **Kompetencat e zgjerura** të Komisionit Shtetëror për Ndhmën Juridike;
2. **Konfuzion në aplikimin e “ndihmës juridike në fushën penale”** lidhur me ndarjen e kompetencave/përgjegjësi të Komisionit Shtetëror të Ndhmës Juridike nga njëra anë dhe Prokurorisë e gjykatave nga ana tjetër;
3. **Mospërfshirja si formë e ndihmës juridike e përjashtimit nga taksat dhe shpenzimet gjyqësore,** veçanërisht “shpenzimet për ekspert” apo “psikolog” (në çështjet familjare), si dhe tarifën për vënien në ekzekutim të titullit ekzekutiv;
4. **Procedura e njëjtë për ndihmën juridike parësore dhe dytësore;**
5. **Mosevidentimi i qartë i personave që legjitimohen** për të përfituar ndihmën juridike;
6. **Mos përcaktimi i një marzhi të ardhurash/pasurish** që kategorizojnë një person me të ardhura të pamjaftueshme;
7. **Përzgjedhja pa kriter e avokatëve** në dhënien e ndihmës juridike falas;

Ligji nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”

•Kuadri Ligjor:

- Ligji nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, hyri në fuqi në Qershor 2018.
- Ligji i ri përcjell një **shtrirje më të plotë** nga pikëpamja normative duke e zgjeruar *objektin* e ndihmës juridike falas dhe rrethin e *subjekteve* që do të përfitojnë nga ky sistem.
- Me ligjin e ri, **ndryshoi i gjithë sistemi i ndihmës juridike**, mënyra e funksionimit dhe organizimit të këtij sistemi duke parashikuar tashmë në mënyrë të detajuar cilët do të jenë ofrues të këtij shërbimi.

Krijohet për herë të parë një rrjetëzim institucionesh përgjegjëse dhe të angazhuara në ofrimin dhe garantimin e shërbimeve juridike me profesionalizëm dhe eficiencë

Miratimi i këtij ligji passolli hartimin e një pakete aketesh nënligjore të cilat synojnë rregullimin në mënyrë të detajuar të çdo procesi mbi ndihmën juridike të garantuar nga shteti

Standardizimi është një tjetër risi thelbësore që solli ky ligj për ndihmën juridike duke krijuar kështu një institucion të ri me procese të standardizuara në përputhje me të gjitha kriteret e kërkuara nga konventat dhe angazhimet mbikombëtare.

Ligji nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”

Krijohet për herë të parë një mekanizëm për mbikëqyrjen dhe kontrollin e shërbimeve të ndihmës juridike të garantuar nga shteti.

(Drejtoria e Mbikëqyrjes së Standardeve të Ofrimit të Shërbimit të Ndhmës Juridike- Monitoron në vjimësi shërbimin e ofruar)

Me hyrjen në fuqi të ligjit të ri, tashmë rritet përgjegjësia e një sërë institucioneve të cilat do të angazhohen në garantimin e aksesit të barabartë në drejtësi përmes shërbimeve ligjore falas.

(Ministria e Drejtësisë; Gjykatat; Prokuroritë; Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë)

Kalimi i kompetencës për të vendosurmbi kërkesat për ndihmë juridike dytësore nga KSHNJ (akt administrativ), tek Gjykatat (Vendim Gjyqësor), është një tjetër risi që sjell ky ligj.

Tashmë vendimi përfundimtar i besohet organeve më të larta publike për dhënien e drejtësisë.

Ligji nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”

•Kudri Ligjor (Format/ Llojet e ndihmës juridike të garantuar nga shteti)

Ndihmë juridike parësore

- Këshillim ligjor;
- Hartim i dokumentave;
- Përfaqësim përpara organeve të administratës publike;
- Dhënia e këshillimit mbi procedurat e ndërmjetësimit;
- Çdo lloj forme tjetër që nuk përbën ndihmë juridike dytësore.

Ndihmë juridike dytësore

- Përpilimi i akteve të nevojshme për të vënë në lëvizje gjykatën;
- Përfaqësimi në gjykatë;
- Jepet me vendim të gjykatës kompetente në bazë të kërkesës së personit

Përrjashtimi nga taksat dhe tarifat gjyqësore

- Formë e ndihmës juridike falas e dhënë me vendim të gjykatës kompetente nëse plotësohen kriteret e përcaktuara në ligj.


Ligji nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”

•Kwadri Ligjor (Subjektet përfitues të ndihmës juridike të garantuar nga shteti)

Personat me të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme

(Për më shumë mbi mënyrën e përlogaritjes së të ardhurave dhe pasurive, do të kemi mundësi të parashtrajmë në vijim të slideve)

Kategoritë e vecanta drejtëpërdrejtë përfituese pavarësisht nga të ardhurat dhe pasuritë

- 
- Viktimat e dhunës në familje;
 - Viktimat e abuzimit seksual;
 - Viktimat e trafikimit;
 - Të miturit në konflikt me ligjin;
 - Personat në institucionet e përkujdesjes shoqërore;
 - Personat me aftësi të kufizuar;
 - Personat përfitues nga skemat e mbrojtjes sociale etj.

Shtetasit përfitues nga sistemi i ndihmës juridike të garantuar nga shteti

- ▶ **Shtetasit Shqiptarë;**
- ▶ **Shtetasit e huaj ose personat pa shtetësi**, të cilët qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë për një periudhë të përkohshme ose të përhershme dhe janë të pajisur me leje qëndrimi;
- ▶ Shtetasit e huaj, ose personat pa shtetësi, që hyjnë në mënyrë të rregullt në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe që **përfitojnë mbi bazën e marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë** ose bazuar në parimin e reciprocitetit;
- ▶ **Azilkërkuesit, personat që gëzojnë statusin e refugjatit** dhe personat që janë në proces ankimi të vendimeve administrative dhe/ose gjyqësore për refuzimin e aplikimit për azil ose revokimin e vendimit të statusit të refugjatit, sipas legjislacionit në fuqi për azilin në Republikën e Shqipërisë.

Kategoritë e vecanta drejtëpërdrejtë përfituese nga ligji për ndihmën juridike

- ▶ **Ndihma juridike i ofrohet personave të mëposhtëm, pavarësisht të ardhurave dhe pasurisë së tyre:**
 - a) viktimave të **dhunës në familje**;
 - b) viktimave të **abuzuar seksualisht** dhe **viktimave të trafikimit** të qenieve njerëzore, në çdo fazë të procedimit penal;
 - c) **viktimave të mitur** dhe të **miturve në konflikt me ligjin**, në çdo fazë të procedimit penal;
 - ç) fëmijëve, të cilët jetojnë në **institucionet e përkujdesjes shoqërore**;
 - d) **fëmijëve nën kujdestari**, të cilët kërkojnë të nisnin një proces pa miratimin e kujdestarit të tyre ligjor ose kundër kujdestarit të tyre ligjor;
 - dh) personave që përfitojnë nga **pagesa për aftësinë e kufizuar**, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën dhe shërbimet shoqërore, duke përfshirë edhe personat që përfitojnë nga statusi i të verbërit.

Kategoritë e vecanta drejtëpërdrejtë përfituese nga ligji për ndihmën juridike

- e) personave, të cilët i nënshtrohen **trajtimit të pavullnetshëm** në **institucionet e shërbimit të shëndetit mendor**, sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi për shëndetin mendor;
- ë) personave, të cilët i nënshtrohen **trajtimit vullnetar** në **institucionet e shërbimit të shëndetit mendor** për sëmundjet e rënda mendore;
- f) personave, ndaj të cilëve kërkohet **heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar**, në çdo fazë të këtij procesi;
- g) personave, të cilëve u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, që kërkojnë të nisin një proces kundër kujdestarit të tyre ligjor, për **rifitimin e zotësisë për të vepruar, pa miratimin e kujdestarit ligjor**;
- gj) personave, të cilët janë përfitues të **skemave të mbrojtjes sociale**;
- h) personave, të cilëve u është cenuar e drejta nëpërmjet një **veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim**, bazuar në vendimin e organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.

Ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike

► Ndhmë Juridike Parësore

1. Qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore;
2. OJF-të autorizuara;
3. Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve

► Ndhmë Juridike Dytësore

1. Avokatët sipas listës së miratuar nga Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë të cilët nënshkruajnë kontratë pranë Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas;

(124 avokatë kanë lidhur kontratën për ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike dytësore për vitin 2021. 161 avokatë kanë lidhur kontratën për ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike dytësore për vitin 2022)

1. Miratimi ose jo i ndihmës juridike dytësore është në diskrecion të Gjykatës së cilës i parashtrohet kërkesa.

Ndihma Juridike Parësore/ Qendrat e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore

Nr.	Qendra	Mbështetës	Inaguruar më	Nr. Punonjësve	Vendndodhja
1	Tiranë	OSFA	Prill 2020	2	Ministria e Drejtësisë
2	Lushnje	Buxhetin e Shtetit	Shtator 2020	1	Pranë Bashkisë Lushnje
3	Pogradec	UNDP	Tetor 2020	2	Pranë Bashkisë Pogradec
4	Gjirokastër	UNDP/Buxhetin e Shtetit	Dhjetor 2020	2	Pranë Pallatit të Sportit Gjirokastër
5	Durrës	UNDP/Buxhetin e Shtetit	Dhjetor 2020	2	Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës
6	Lezhë	UNDP	Dhjetor 2020	1	Pranë Bashkisë Lezhë
7	Shkodër	UNDP/Buxhetin e Shtetit	Dhjetor 2020	2	Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër
8	Vlorë	UNDP	Shkurt 2021	2	Pranë Bashkisë Vlorë
9	Dibër	UNDP	Shkurt 2021	2	Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër
10	Fier	UNDP	Shkurt 2021	1	Pranë Këshillit të Qarkut Fier
11	Berat	UNDP	Korrik 2022	2	Pranë Bashkisë Berat
12	Elbasan	UNDP	Korrik 2022	2	Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan

Harta e Qendrave të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore

Shkodër

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër

Lezhë

- Bashkia Lezhë

Durrës

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës

Tiranë

- Ministria e Drejtësisë

Fier

- Këshilli i Qarkut Fier

Vlorë

- Bashkia Vlorë

Dibër

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër

Elbasan

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan

Berat

- Bashkia Berat

Lushnje

- Bashkia Lushnje

Pogradec

- Biblioteka "Mitrush Kuteli", Pogradec

Gjirokastër

- Pallati i Sportit, Gjirokastër



Ndihma Juridike Parësore/ Organizatat Jofitimpruese të autorizuara


Nr.	Emërtimi i OJF-së
1	Forumi i Gruas Elbasan (FGE)
2	Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri (CRCA)
3	Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (QNL)
4	Qendra Psiko-Sociale Vatra
5	Qendra e Gruas Hapa të Lehtë
6	Qendra ALTRI
7	Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza
8	Shoqata “Mbrojtja e të Drejtave të Gruas Fshatare dhe Qytetare Berat”

9	Shoqata “Shërbimet shqiptare për refugjatët dhe migrantët”
10	Organizata “Refleksione”
11	Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin
12	Qendra “Konsumatori Shqiptar”
13	Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara
14	Organizata “Të ndryshëm dhe të barabartë”
15	Organizata “Shërbimi ligjor falas Tiranë”

Ndihma Juridike Parësore/ Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve

- **Ndihma Juridike Parësore/ Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve**

1. Marrëveshje Bashkëpunimi me **Fakultetin e Drejtësisë;**
2. Marrëveshje Bashkëpunimi me **Kolegjin Universitar Bedër;**
3. Marrëveshje Bashkëpunimi me **Kolegjin Universitar ëisdrom;**
4. Marrëveshje Bashkëpunimi me **Universitetin European të Tiranës;**
5. Marrëveshje Bashkëpunimi me **Universitetin Aleksandër Moisiu Durrës;**
6. Marrëveshje Bashkëpunimi me **Universitetin Ismail Qemali Vlorë;**
7. Marrëveshje Bashkëpunimi me **Kolegjin Universitar Qiriazi;**
8. Marrëveshje Bashkëpunimi me **Universitetin Mesdhetar;**
9. Marrëveshje Bashkëpunimi me **Fondacionin OSFA (Klinika e Ligjit Shkodër);**
10. Marrëveshje Bashkëpunimi me **Universitetin Marin Barleti;**
11. Marrëveshje Bashkëpunimi me **Universitetin Epoka;**
12. Marrëveshje Bashkëpunimi me **Universitetin Luarasi.**



**Urdhër i Ministrit të Drejtësisë nr. 225 datë 25.03.2019,
“për miratimin e formularëve të ndihmës juridike të garantuar nga shteti”**

NDIHMA PARËSORE

- Formulari i kërkesës dhe vetëdeklarimit për ndihmë juridike parësore
- Formulari i vetëdeklarimit për të ardhurat dhe pasuritë
- Formulari i vetëdeklarimit për kategoritë e veçanta

NDIHMA DYTËSORE

- Formulari i kërkesës kërkesës dhe vetëdeklarimit për ndihmë juridike dytësore
- Formulari i vetëdeklarimit për të ardhurat dhe pasuritë
- Formulari i vetëdeklarimit për kategoritë e veçanta
- Formulari i ankimit ndaj vendimit për rrëzimin e kërkesës për ndihmë juridike dytësore

**PËRJASHTIM NGA
TASKAT DHE TARIFAT
GJYQËSORE**

- Formulari i kërkesës për përjashtimin nga taksat dhe tarifat gjyqësore

Si ofrohet ndihma juridike parësore?

• Neni 17 i Ligji nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”

- ✓ Kërkesa për ndihmë juridike parësore bëhet me gojë ose me shkrim pranë ofruesve të ndihmës juridike parësore;
- ✓ Në momentin e paraqitjes pranë ofruesit të shërbimit, **kërkuesi plotëson dhe nënshkruan formularin e vetëdeklarimit** të miratuar me Udhër të Ministrit të Drejtësisë;
- ✓ **Ofruesit të shërbimit nuk i lind detyrimi të kërkojë dokumentacion provues** se kërkuesi është kategori përfituese e ligjit. **Me nënshkrimin e këtij formulari, kërkuesi mban përgjegjësi penale dhe administrative në rastet e deklarimit të rremë;**
- ✓ **Nëse plotësohen kushtet, ndihma juridike parësore jepet menjëherë.** Pavarësisht këtij fakti, nisur nga kompleksiteti i çështjes, kërkuesit mund ti caktohet një datë tjetër për të marrë shërbimin e kërkuar;
- ✓ **Ofruesi i shërbimit ka detyrim të administrojë një kopje** të formularit të vetëdeklarimit; një proces-verbal ku parashtrohet procedura e ndjekur për trajtimin e rastit si dhe një kopje të dokumentit administrativ të hartuar (nëse ka të tillë);
- ✓ **Çdo ofrues i shërbimit të ndihmës juridike parësore, ka detyrimin të raportojë brenda datës 5 (pesë) të çdo muaji, mbi numrin e rasteve të trajtuara si dhe elementëve specifikë të përcaktuar në udhëzimin nr. / 2019 të Ministrit të Drejtësisë.**

Si ofrohet ndihma juridike dytësore?

- ▶ **(Ndhma Juridike Dytësore)**, është shërbimi juridik që ofrohet për përpilimin e akteve të nevojshme për të vënë në lëvizje gjykatën; ofrimi i këshillimit, përfaqësimit dhe mbrojtjes para gjykatës në çështjet administrative, civile dhe në çështjet penale, për të cilat nuk zbatohet mbrojtja e detyrueshme, sipas përcaktimeve të legjislacionit procedural penal.
- ▶ Kjo lloj ndihme ofrohet nga avokatët e licencuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë të cilët kanë lidhur marrëveshje me DNJF.

- ▶ Personi me anë të avokatit falas i drejtohet gjykatës për zgjidhjen e çështjeve apo problematikave të çdo fushe (*civile, penale, administrative*) përmes depozitimit të formularit të vetëdeklarimit (*sipërcituar*).
- ▶ Gjithashtu, personat që përfitojnë nga kjo formë e ndihmës juridike **mund të përfitojnë përjashtim nga:**
 1. **Pagimi i tarifave dhe shpenzimeve gjyqësore** (*shpenzimet për dëshmitarët, ekspertët, përkthyesit*);
 2. **Parapagimi i tarifës së ekzekutimit të vendimit** pranë shërbimit përmbartimor gjyqësor shtetëror.

Ku duhet të drejtohen qytetarët për të marrë ndihmë juridike dytësore?

► **Pranë Gjykatave apo Prokurorive kompetente**

- ✓ **Neni 19:** Kërkesa për dhënien e ndihmës juridike dytësore paraqitet nga personi i interesuar personalisht ose nëpërmjet postës, përpara fillimit të një procesi gjyqësor, në çdo fazë të procesit gjyqësor, **derisa nuk është deklaruar i mbyllur hetimi gjyqësor;**
- ✓ Personi që gëzon të drejtën për ndihmë juridike dytësore, **mund ta paraqesë kërkesën nëpërmjet një përfaqësuesi ligjor** apo të pajisur me prokurë, ose nëpërmjet bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/es ose një të afërmi të shkallës së parë.
- ✓ Personi, i cili kërkon të përfitojë ndihmë juridike dytësore, **nënshkruan një vetëdeklarim** se përmbush kriteret e përfitimit, të përcaktuara në këtë ligj, sipas formularit të vetëdeklarimit të miratuar nga Ministri i Drejtësisë, **të shoqëruar me dokumentacionin justifikues (në dallim nga ndihma juridike parësore)**
- ✓ **Fakti që kërkuesi depoziton kërkesën në gjykatën jo kompetente nuk është arsye për të rrëzuar kërkesën** (*transferohet kërkesa në gjykatën kompetente sipas KPC*)
- ✓ **Kërkesa është e përjashtuar nga tarifat dhe kostot gjyqësore.**

Shqyrtimi i kërkesës për ndihmë juridike dytësore nga Prokuroria

- ▶ Në rast se kërkesa për ndihmë juridike dytësore paraqitet nga i pandehuri pa mjete të mjaftueshme financiare, **organi procedues që fillon hetimet shqyrton menjëherë nëse përmbushen kriteret e përcaktuara ;**
- ▶ Nëse organi procedues që fillon hetimet vlerëson se kriteret janë përmbushur, **cakton menjëherë një avokat mbrojtës nga lista e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore** dhe njofton menjëherë personin, të cilit i ofrohet ndihmë juridike dytësore, si dhe avokatin e caktuar mbrojtës;
- ▶ **Vendimi për pranimin ose rrëzimin e kërkesës për ndihmë juridike dytësore jepet i arsyetuar dhe i njoftohet kërkuarit dhe Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas;**
- ▶ **Kërkuari mund ta kundërshtojë vendimin e organit procedues për rrëzimin e kërkesës për ndihmë juridike dytësore, me padi në gjykatën penale të shkallës së parë, kompetente për shqyrtimin e çështjes në themel, brenda 5 ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim.**

Shqyrtimi i kërkesës për ndihmë juridike dytësore nga Gjykata

- ✓ **Vendimi në lidhje me kërkesën për ndihmë juridike dytësore** merret nga gjykata kompetente (*vendim i ndërmjetëm*):
 - a) **brenda 5 ditëve nga data e regjistrimit të kërkesës**, kur kërkesa paraqitet përpara fillimit të procesit gjyqësor;
 - b) **gjatë veprimeve paraprake ose në seancën përgatitore** përpara se të caktohet seanca gjyqësore, kur kërkesa për ndihmë juridike është paraqitur bashkë me kërkesë-padinë;
 - c) sipas parashikimeve të legjislacionit procedural dhe dispozitave të këtij ligji, kur kërkesa paraqitet **gjatë shqyrtimit gjyqësor**.
 - ✓ Në rastet kur kërkuesi deklaron pamundësinë për sigurimin e dokumentacionit, **gjykata mund të urdhërojë dorëzimin e dokumentacionit të nevojshëm nga organet e administratës shtetërore që e disponojnë atë**. Në këto raste kërkesa për ndihmë juridike dytësore quhet e paraqitur në përfundimin e afatit të vendosur nga gjykata për paraqitjen e dokumentacionit plotësues nga organet e administratës shtetërore;
- Fakti që aplikanti nuk përdor formularët, por jep të gjitha informacionet dhe dokumentacionin e nevojshëm për të shqyrtuar kërkesën e tij, aplikimi i tij për ndihmë juridike nuk mund të hidhet poshtë.**

Procedura e caktimit të avokatit ofrues të shërbimit të ndihmës juridike dytësore

- **Në rast të pranimin të kërkesës për ndihmë juridike dytësore:**
 1. Pas njoftimit të vendimit, **dhoma vendore e avokatisë cakton një avokat nga lista e avokatëve** që japin shërbimet e ndihmës juridike dytësore, **sipas parimit të rotacionit** (*procedura e rotacionit përcaktohet në udhërrëfuesin nr. 17/2020, të Ministrisë së Drejtësisë dhe DHASH*);
 2. Dhoma vendore e avokatisë përcjell vendimin e gjykatës kompetente, së bashku me vendimin e saj mbi caktimin e avokatit, këtij të fundit dhe personit të cilit i është pranuar kërkesa për ndihmën juridike dytësore.
 3. **Avokati i caktuar, menjëherë, hyn në marrëdhënie me personin**, të cilit i është pranuar kërkesa për ndihmë juridike dytësore dhe fillon dhënien e shërbimeve të kërkuara.
 4. **Avokati i caktuar zëvendësohet nga një avokat tjetër**, nga lista e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore, **vetëm në rast se konstatohet një konflikt interesi** midis avokatit dhe personit, të cilit i është pranuar kërkesa për ndihmën juridike dytësore.
 5. Vendimi për zëvendësimin e avokatit të caktuar nga një avokat tjetër nga lista e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore merret nga: a) organi procedues, në rast se avokati që do të zëvendësohet është caktuar nga ky organ; b) dhoma vendore e avokatisë, në rast se avokati që do të zëvendësohet është caktuar prej saj.

Procedura e pagesës së avokatit ofrues të shërbimit të ndihmës juridike dytësore

- ✓ **Neni 16 i Ligjit për Avokatinë** përcakton se pagesa e avokatit për punën e kryer do të vendoset, në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi për ndihmën juridike të garantuar nga shteti;
- ✓ **Akti nënligjor për tarifën dhe pagesën e avokatëve (Udhëzim i Përbashkët Nr. 18, datë 5.8.2020, për miratimin e kriterëve për marrjen e pagesave dhe tarifave të shpërblimit për avokatët që ofrojnë ndihmë juridike dytësore);**
- ✓ **Kriteret / Procedura e Shpërblimit:** Pas përfundimit të procedurave të ndihmës juridike, avokati duhet të paraqesë pranë Drejtorisë formularin për shpërblimin me qëllim kryerjen e pagesës nga buxheti i DNJF’
Kur avokati heq dorë nga ofrimi i ndihmës juridike dytësore, ai nuk do të ketë të drejtë kompensimi për shërbimin e ofruar;
- ✓ Avokatët kanë të drejtë për
 - tarifa (siç parashikohet në aneksin e udhëzimit) dhe
 - rimbursimin e shpenzimeve në përputhje me legjislacionin në fuqi, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punësimit, brenda vendit”.

1. NDIHMA JURIDIKE NË ÇËSHTJET PENALE		Tarifat
1	Përfaqësimi në çështjet penale	
	Shërbimi në lidhje me ndalimin dhe arrestimin deri në ndryshimin e masës së sigurisë	15 000
2	Ndihma juridike për hetimin paraprak deri në dërgimin e çështjes në gjykatë	
	Për kundërvajtjet penale	20 000
	Për krime që dënohen deri në 10 vjet burg në gjykatën e rrethit gjyqësor	50 000
	Për krime që dënohen me më shumë se 10 vjet burg në Gjykatën Speciale të Shkallës së Parë për korrupsion dhe krim të organizuar	60 000
3	Ndihmë ligjore dhe për gjykime në shkallë të parë	
	Për kundërvajtjet penale	20 000
	Për krime që dënohen deri në 10 vjet burg në gjykatën e rrethit gjyqësor	30 000
	Për krime që dënohen me më shumë se 10 vjet burg në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor	80 000
	Për krimet e gjykuara në Gjykatën Speciale të Shkallës së Parë për korrupsion dhe krim të organizuar	96 000
4	Ndihma juridike për gjykime në gjykatat e apelit, gjykatën e lartë dhe gjykatën kushtetuese	
	Për gjykimet në gjykatat e apelit	40 000
II. NDIHMA JURIDIKE NË FUSHËN CIVILE DHE ADMINISTRATIVE		
1	Përfaqësimi në shkallën e parë	
	Përfaqësimi në shkallën e parë, pa palë kundërshtare	15 000
	Përfaqësimi në shkallën e parë, me palë kundërshtare	40 000
2	Përfaqësimi në gjykatën e apelit, gjykatën e lartë dhe atë kushtetuese	
	Përfaqësimi në gjykatën e apelit	45 000

	Përfaqësimi në gjykatën e lartë dhe atë kushtetuese	60 000
3	Shërbime juridike jashtë-gjyqësore	
	Përgatitja e ankesës	15 000
	Rekursi në Gjykatën e Lartë dhe Kërkesa në Gjykatën Kushtetuese	25 000
	Sigurimi i ndihmës juridike në formë këshillimi	500 - 15 000 ALL/orë
III. SHËRBIME TË TJERA JURIDIKE		
	Shërbime të tjera juridike të cilat nuk janë përfshirë në pikat e mësipërme	

Ndihma Juridike Falas, përjashtimit nga taksat dhe tarifat gjyqësore

- ▶ Personat, të cilët kanë të drejtën për të marrë ndihmë juridike dytësore, sipas neneve 11 ose 12, të ligjit, gëzojnë të drejtën për përjashtim nga:
 - ▶ a) pagimi i tarifave të përgjithshme dhe të veçanta, sipas përcaktimeve të ligjit për tarifat gjyqësore në Republikën e Shqipërisë;
 - ▶ b) pagimi i shpenzimeve gjyqësore shpenzimet për dëshmitarët, ekspertët, përkthyesit dhe për këqyrjen e sendeve ose këqyrjen në vend), sipas përcaktimeve të legjislacionit procedural;
 - ▶ c) detyrimi për të parapaguar tarifën e vënies në ekzekutim të urdhrit të ekzekutimit pranë shërbimit përmbarimor gjyqësor shtetëror.
- ▶ **Kërkesa bëhet në gjykatën që shqyrton çështjen në themel.**

Përfituesit e ndihmës juridike me të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme

► Përfituesit e ndihmës juridike me të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme

Të drejtën për të përfituar ndihmë juridike e ka çdokush që provon se ka të **ardhura** dhe **pasuri** të pamjaftueshme për të përballuar shpenzimet për këshillim, përfaqësim dhe/ose mbrojtje në çështjet penale, në çështjet administrative dhe në çështjet civile.

“Të ardhura”, në kuptim të ligjit për ndihmën juridike, janë të ardhurat mujore që sigurohen nga pagat, veprimtaria ekonomike, interesat e depozitave bankare, të ardhurat nga pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme. **Në këto të ardhura nuk përfshihet:**

- ndihma ekonomike,
- pensioni social,
- pagesat e papunësisë,
- përfitimet e invalidëve, sipas statusit të invalidit të punës ose të luftës,
- pagesat që marrin **pjesëtarët e familjes që kujdesen** për personin me aftësi të kufizuara,
- **rimbursimi i shpenzimeve për energji,**
- **rimbursimet për ilaçe e mjekime** për të sëmurët kronikë dhe paketa higjieno-shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara.

Mënyra e përlogaritjes së të ardhurave dhe pasurive, për të qenë kategori përfituese e ligjit

Kur personi jeton ne familje: “Konsiderohen të pamjaftueshme, nëse të ardhurat në total të të gjithë/ pjesëtarëve të familjes, të pjesëtuara për numrin e anëtarëve të familjes, janë më të ulëta se 50 për qind e pagës minimale mujore”;

Paga minimale në shkallë vendi është 34.000 lekë. $50\% = 17.000$ lekë.

Shembull: Në një familje me 4 anëtarë ku 2 prej të cilëve janë të punësuar me pagë minimale të ardhurat mujore vlerësohen me 68.000 lekë. Vlera sipas kategorisë përkatëse llogaritet $68.000 \text{ lekë} / 4 \text{ persona} = 17.000$ lekë.

Personi, i cili nuk jeton në një familje: “Konsiderohen të pamjaftueshme të ardhurat nëse janë më të ulëta se niveli i pagës minimale mujore”.

Personi, i cili kërkon ndihmë ligjore për një çështje kundrejt një anëtari tjetër të familjes: “Konsiderohen të pamjaftueshme të ardhurat nëse janë më të ulëta se niveli i pagës minimale mujore”.

Mënyra e përlogaritjes së të ardhurave dhe pasurive, për të qenë kategori përfituese e ligjit

- ▶ Paga minimale është përcaktuar në:
- ▶ VKM Nr. 604, datë 14.9.2022 “PËR PËRCAKTIMIN E PAGËS MINIMALE NË SHKALLË VENDI”
- ▶ Paga bazë minimale mujore për punonjësit në shkallë vendi, që është e detyrueshme të zbatohet nga çdo person, juridik a fizik, vendas ose i huaj, të jetë **34 000 (tridhjetë e katër mijë) lekë.**

Mënyra e përlogaritjes së të ardhurave dhe pasurive, për të qenë kategori përfituese e ligjit

- ▶ **Pasuria** e një personi konsiderohet e pamjaftueshme, nëse vlera e saj në total nuk tejkalon vlerën e 36 pagave minimale mujore sipas legjislacionit në fuqi. ($36 \times 34000 = 1,224,000$ leke)
- ▶ “Pasuri”, në kuptim të ligjit nr. 111/2017, është pasuria e çdo lloji, e luajtshme ose e paluajtshme, si dhe të drejtat reale pasurore.
Pasuria e paluajtshme e përdorur nga pronari ose bashkëpronari si banesë e tij parësore për jetesën familjare dhe sendet e përjashtuara nga sekuestrimi, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Civile, nuk konsiderohen pasuri, sipas kuptimit të këtij ligji.

Mënyra e përlogaritjes së të ardhurave dhe pasurive, për të qenë kategori përfituese e ligjit

► Referuar nenit 529 të Kodit të Procedurës Civile, përjashtohen nga sekuestrimi i pasurisë së debitorit dhe nuk konsiderohen si pasuri referuar ligjit për ndihmën juridike:

1. **Sendet e përdorimit personal të debitorit** dhe të familjes së tij si: veshjet, shtresat, mbulesat, mobiljet për aq sa ato janë të nevojshme për jetesën e tyre;
2. **Ushqimet dhe lëndët djegëse që i nevojiten debitorit** dhe familjes së tij për tre muaj;
3. **Dekoratat dhe sende kujtimi, letra, shkresa të familjes dhe librat profesionalë;**
4. **Librat, veglat muzikore, mjetet e artit** që nevojiten për veprimtarinë shkencore dhe artistike të debitorit dhe të familjes së tij;
5. **Deri 3 dynmë tokë, 2 kafshë për punimin e tokës**, 1 lopë, 6 dele ose 6 dhi, fara për mbjelljen e ardhshme, si dhe ushqimi i këtyre kafshëve për 3 muaj për personat që jetojnë me punë bujqësore ose blegtorale;
6. **Ndihma që u jepet nënave me shumë fëmijë ose të vetme, pensionet e pleqërisë, të invaliditetit ose familjarë ose bursa e studimit përveç kur detyrimi është për ushqim.** Në këtë rast nuk mund të sekuestrohet më shumë se 1/2 e shumës së pensionit ose të bursës;
7. **Frutat natyrore një muaj para se ato të piqen.**
8. **Sendet e nevojshme të punës për sigurimin e jetesës.**

Si vërtetohen të ardhurat dhe pasuritë në një familje në kuptim të ligjit për ndihmën juridike?

Kur personi jeton në familje: “Konsiderohen të pamjaftueshme, nëse të ardhurat në total të të gjithë/ pjesëtarëve të familjes, të pjesëtuara për numrin e anëtarëve të familjes, janë më të ulëta se 50 për qind e pagës minimale mujore”. **Pasuria** e një personi konsiderohet e pamjaftueshme, nëse vlera e saj në total nuk tejkalon vlerën e 36 pagave minimale mujore sipas legjislacionit në fuqi. ($36 \times 34000 = 1,224,000$ leke)

Pas përcjelljes së dokumentacionit:

1. Certifikate familjare;
2. Certifikate personale;
3. **Vërtetim që nuk ka pasuri të paluajtshme** personi si dhe të gjithë anëtarët e familjes me të cilët rezultojnë në certifikatë familjare (gjenerohet në e-albania);
4. Vërtetim nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor që personi si dhe të gjithë anëtarët e familjes me të cilët rezultojnë në certifikatë familjare nuk kanë në pronësi automjete;
5. Vërtetim që personi si dhe të gjithë anëtarët e familjes me të cilët rezultojnë në certifikatë familjare nuk kanë biznes (gjenerohet në e-albania);
6. Vërtetim page të personit si dhe të gjithë anëtarëve të familjes me të cilët rezultojnë në certifikatë familjare;
7. Depozitë bankare;
8. Vërtetim papunësie nga Zyra e Punës të personit si dhe të gjithë anëtarëve të familjes me të cilët rezultojnë në certifikatë familjare (gjenerohet në e-albania).

Në përfundim të dorëzimit të dokumentacionit të lartpërmendur, totali i të ardhurave do të përpjesëtohet me numrin e anëtarëve sipas certifikatës familjare. **Nëse vlera që do të dalë është më e ulët se 50 për qind e pagës minimale mujore dhe vlera e pasurive të paluajtshme është me e ulët se 1,224,000 leke, atëherë personi do të jetë përfitues sipas ligjit.**

Si përlogariten të ardhurat në një familje për një çështje kundër një anëtar tjetër të së njëjtës familje, në kuptim të ligjit për ndihmën juridike?

Nëse një person, i cili jeton në një familje, kërkon ndihmë juridike dytësore **për një çështje kundër një anëtar tjetër të së njëjtës familje**, të ardhurat e këtij personi konsiderohen të pamjaftueshme, nëse janë më të ulëta se niveli i pagës minimale të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi.

Pas përcjelljes së dokumentacionit:

1. Certifikatë familjare;
2. Certifikatë personale;
3. Vërtetim që nuk ka pasuri të paluajtshme (*gjenerohet në e-albania*);
4. Vërtetim nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor që aplikanti nuk ka në pronësi automjete;
5. Vërtetim që personi nuk ka biznes (*gjenerohet në e-albania*);
6. Vërtetim page;
7. Depozitë bankare;
8. Vërtetim papunësie nga Zyra e Punës (*gjenerohet në e-albania*).

Në përfundim të dorëzimit të dokumentacionit të lartpërmendur, **nëse totali i të ardhurave të personit do të jenë më të ulëta se paga minimale mujore në RSH, atëherë personi do të jetë përfitues sipas ligjit.**

ZHVILLIMET KRYESORE (JANAR - SHTATOR 2022)

- **Lidhur Marrëveshja e Bashkëpunimit me nr. 765/I prot., dt. 15.02.2022 midis Ministrisë së Drejtësisë dhe UNDP/ADA** (Shkurt 2022-Janar 2023) për mbështetjen e Qendrave aktuale të ndihmës juridike si dhe hapjen e Qendrave të reja në vlerën 17.000.000 lekë
- **39 ofrues të shërbimit parësor në rreth 95% të territorit të R.SH sipas qarqeve** (12 Qendra të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore; 15 organizata jofitimprurëse të autorizuara; 12 marrëveshje bashkëpunimi me Klinikat Ligjore pranë IAL-ve)
- **Plotësuar struktura e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas me 4 (katër) qendra me buxhet shteti** (Tiranë, Lushnje si dhe Shkodër, Durrës për vitin 2022) si dhe hapja e 2 (dy) qendrave të reja me mbështetjen e UNDP në Berat dhe Elbasan
- **DNJF administron 12 qendra** në Tiranë, Durrës, Elbasan, Lushnje, Berat, Fier, Vlorë, Pogradec, Gjirokastrë, Lezhë, Shkodër dhe Dibër me 23 punonjës në total

ZHVILLIMET KRYESORE (JANAR - SHTATOR 2022)

- Në vijim të 6 mujorit të dytë të vitit 2022, **do të hapen dhe 2 Qendra të Shërbimit Parësor në Kukës dhe Korçë** dhe me qëllim mbulimin 100% të teritorit të Republikës së Shqipërisë sipas qarqeve, me shërbim juridik falas;
- **15 (pesëmbëdhjetë) organizata jofitimprurëse të autorizuara** nga Ministri i Drejtësisë në muajin Shtator 2022 *(3 organizata më shumë se në muajin Shtator 2020)*
- **Zhvillimi i trajnimeve për 234 studentë të angazhuar pranë Klinikave të Ligjit** si dhe zhvillimi praktikave pranë DNJF, Qendrës Tiranë, Vlorë dhe Shkodër për 37 studentë
- **Angazhim i DNJF në kuadër të Strategjive ku institucioni është i përfshirë** si SELP; SND; SNKK; SDM; si dhe në kuadër të procesit të Integritetit Europian

ZHVILLIMET KRYESORE (JANAR - SHTATOR 2022)

- **Promovimi i sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti** nëpërmjet zhvillimit të 233 aktiviteve ndërgjegjësuese/promovuese (65 aktivitete për periudhën Shtator-Dhjetor 2021 dhe 168 aktivite për periudhën Janar-Shtator 2022); promovimit në faqen zyrtare dhe rrjetet sociale të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas si dhe publikimit të Buletinit Informativ në baza periodike.
- **Zhvilluar 7 intervista televizive në televizionet lokale** nga Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore (2 intervista për periudhën Shtator-Dhjetor 2021 dhe 5 intervista për periudhën Janar-Shtator 2022)
- **Zhvilluar procedura e shortit për përgatitjen e listës dhe caktimin e avokatëve** që do të ofrojnë ndihmë juridike dytësore për vitin 2022 dhe Lidhur kontratat me avokatët për ofrimin e ndihmës juridike me 159 avokatë me mbulim në rreth 100% të territorit të R.SH sipas qarqeve;
- **Zhvilluar trajnimi i detyrueshëm i avokatëve të ndihmës juridike dytësore** në bashkëpunim me Dhomën Kombëtare të Avokatisë dhe UNDP

ZHVILLIMET KRYESORE (JANAR - SHTATOR 2022)

- **Janë kryer 29 monitorime fillestare dhe të vazhdueshme për Qendrat e Ndhmës Juridike Parësore** dhe vijon procesi i monitorimit për avokatët ofrues të ndihmës juridike dytësore në bazë të dosjeve të administruara për pagesë
- Bashkëpunimi ndërinstytucional: **Lidhur 17 marrëveshje bashkëpunimi me institucionet në nivel qendror, vendor institucionet e pavarura dhe gjykatat**, në kuadër të referimit të rasteve dhe ndërgjegjësimit
- Vijuar bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare mbështetëse: **UNDP/ADA; OSFA/CLE; Caritas Shqiptar.**
- **Ofrimi i shërbimit të ndihmës juridike online** (*Platforma juristionline.al*) në bashkëpunim me OSFA dhe i numrit i gjelbër 08001010 (tashmë i aksesueshëm nga të gjithë operatorët telefonikë)

ZHVILLIMET KRYESORE (JANAR - SHTATOR 2022)

- **4979 raste këshillimi ligjor falas të raportuara nga ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore** për vitin periudhën Janar-Shtator 2022, ku në 63% të rasteve kanë përfituar gratë dhe vajzat në nevojë.
- **812 persona kanë përfituar ndihmë juridike dytësore dhe përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore** për periudhën Janar-Shtator 2022. Në 62% të rasteve kanë përfituar gratë dhe vajzat në nevojë
- Vlerësimi i shërbimit të ndihmës juridike për periudhën Janar –Shtator 2022 ka konkluduar **82 vendime gjyqësore me vlerë totale prej 6,182,740 lekë.**

FALEMINDERIT !

**PROGRAMI I TRAJNIMIT TË
PARALIGJORËVE**

**KATEGORITË E VEÇANTA PËRFITUESE NGA
LIGJI PËR NDIHMËN JURIDIKE TË
GARANTUAR NGA SHTETI**


TETOR 2022



Centre for Legal
Empowerment

www.cle.al

Çështjet që do të trajtohen gjatë trajnimit



Cilat janë kategoritë e vecanta, drejtëpërdrejtë përfituese sipas ligjit nr. 111/2017?

Kuptimi i dhunës në familje dhe viktimat e dhunës

Mbrojtja ligjore dhe të drejtat e viktimave të dhunës si kategori të vecanta.

Kategoria e të miturve në konflikt me ligjin

Mbrojtja ligjore dhe të drejtat e të miturve në konflikt me ligjin.

Si ti trajtojmë kategoritë e veçanta?

Pyetje dhe diskutime të rasteve specifike.

Kategoritë e veçanta të përfituesve të ndihmës juridike

- ▶ **Ndihma juridike i ofrohet personave të mëposhtëm, pavarësisht të ardhurave dhe pasurisë së tyre:**
 - a) viktimave të **dhunës në familje**;
 - b) viktimave të **abuzuar seksualisht** dhe **viktimave të trafikimit** të qenieve njerëzore, në çdo fazë të procedimit penal;
 - c) **viktimave të mitur** dhe të **miturve në konflikt me ligjin**, në çdo fazë të procedimit penal;
 - ç) fëmijëve, të cilët jetojnë në **institucionet e përkujdesjes shoqërore**;
 - d) **fëmijëve nën kujdestari**, të cilët kërkojnë të nisnin një proces pa miratimin e kujdestarit të tyre ligjor ose kundër kujdestarit të tyre ligjor;
 - dh) personave që përfitojnë nga **pagesa për aftësinë e kufizuar**, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën dhe shërbimet shoqërore, duke përfshirë edhe personat që përfitojnë nga statusi i të verbërit.

Kategoritë e veçanta të përfituesve të ndihmës juridike

- e) personave, të cilët i nënshtrohen **trajtimit të pavullnetshëm në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor**, sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi për shëndetin mendor;
- ë) personave, të cilët i nënshtrohen **trajtimit vullnetar në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor** për sëmundjet e rënda mendore;
- f) personave, ndaj të cilëve kërkohet **heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar**, në çdo fazë të këtij procesi;
- g) personave, të cilëve u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, që kërkojnë të nisnin një proces kundër kujdestarit të tyre ligjor, për **rifitimin e zotësisë për të vepruar**, pa miratimin e kujdestarit ligjor;
- gj) personave, të cilët janë **përfitues të skemave të mbrojtjes sociale**;
- h) personave, të cilëve u është cenuar e drejta nëpërmjet një **veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim**, bazuar në vendimin e organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.

Viktimat e dhunës në familje




Ç'kuptoni me dhunë në familje? Cilat janë format e dhunës në familje të adresuara nga kërkuesit e ndihmës juridike parësore?



Format e Dhunës


- DhG ka shumë forma dhe ndodh në shumë vende.





“Dhunës në familje ” si çdo veprim ose mosveprim i një personi ndaj një personi tjetër, **që ndodh brenda familjes ose njësisë shtëpiake**, e ushtruar **ndërmjet pjesëtarëve të familjes**, që janë ose kanë qenë në marrëdhënie familjare, pavarësisht nga fakti nëse dhunuesi ndan ose ka ndarë të njëjtën banesë me viktimën që sjell si pasojë cenim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, ekonomik.

Viktimat e dhunës në familje



Viktimat e dhunës në familje

- ▶ **Sipas Ligjit Nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa kundër dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar, sqarohet:**
 - ✓ **“Dhunë” është çdo veprim ose mosveprim i një personi ndaj një personi tjetër, që sjell si pasojë cënim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, ekonomik.**
 - ✓ **“Viktimë e dhunës” është cilido individ ndaj të cilit është ushtruar dhunë.**
 - ✓ **“Dhunë në familje” është çdo akt dhune që ndodh brenda familjes ose njësisë shtëpiake, e ushtruar ndërmjet pjesëtarëve të familjes.**

Ç'kuptojmë me anëtarë familje?

01

Bashkëshorti/ja/
bashkëpjetues/e + ish

02

Vëllezërit, motrat, nipi,
mbesa,

03

paraardhësit./pasardhësit në
vijë të drejtë

04

Prindërit e bashkëshortit/es
bashkëjetuesit/es (birësimi)

05

Vëllezërit/ motrat e
bashkëshortit/es
bashkëjetuesit/es

06

Fëmijët e bashkëshortit/es
bashkëjetuesit/es

07

Personat në marrëdhënie
intime/ jo bashkëjetesë

08

Kujestari dhe personi nën
kujdestari

Anëtarë
familje?

Ç'kuptojmë me anëtarë familje?

► Pjesëtarë të familjes janë:

a) bashkëshorti/ja ose bashkëjetuesi/ja apo ish-bashkëshorti/ja apo ish-partneri/ja bashkëjetues; b) vëllezërit, motrat, përfshirë, sipas rastit, edhe bashkëshortin/en ose bashkëjetuesin/en e tyre, si dhe nipin e mbesën, nëse këta të fundit janë anëtarë të njësisë shtëpiake; c) paraardhësit dhe pasardhësit në vijë të drejtë, pa kufizime, përfshirë edhe rastet kur kjo marrëdhënie krijohet nëpërmjet birësimit; ç) prindërit e bashkëshortit/es ose të bashkëjetuesit/es, përfshirë dhe thjeshtin/thjeshtren, edhe sikur kjo lidhje të burojë nga birësimi; d) gjinia në vijë të drejtë, përfshirë edhe prindërit, edhe fëmijët e birësuar të bashkëshortit/es ose bashkëjetuesit/es; dh) vëllezërit dhe motrat e bashkëshortit, bashkëshortes, bashkëjetuesit/es; e) fëmijët e bashkëshortëve ose partnerëve bashkëjetues; ë) **personat, të cilët janë ose kanë qenë në marrëdhënie intime, jo domosdoshmërisht të shoqëruar me bashkëjetesë, gëzojnë të njëjtën mbrojtje**; f) kujdestari dhe personi që ndodhet në kujdesin e tij gjatë kohës që vazhdon kujdestaria, sipas përcaktimeve të kujdestarisë mbi të miturit dhe kujdestarisë për personat me aftësi të kufizuar dhe personit që i është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar sipas dispozitave të Kodit të Familjes”.

Të drejtat e viktimave të dhunës në familje?

Të denoncojnë dhunën në familje pranë çdo stacioni policie/ ndihmë ligjore falas

Të kërkojnë ndjekjen penale të fajtorit/ komunikojë në gjuhën e saj dhe të ndihmohet nga një përkthyes, interpretues i gjuhës së shenjave ose lehtësues i komunikimit për personat me aftësi të kufizuara në të folur dhe në të dëgjuar;

Mbrojtje e menjëhershme/ strehim në qendrat pritëse;

Të kenë kujdes mjekësor, ndihmë psikologjike, këshillim dhe shërbime të tjera të ofruara nga autoritetet, organizatat ose institucionet përgjegjëse për ndihmën ndaj viktimave të dhunës.

Të kërkojnë në çdo kohë informacion për gjendjen e procedimit, si dhe të njihet me aktet e provat, të njoftohet për mosfillimin e procedimit, pushimin e çështjes, fillimin dhe përfundimin e gjyqimit;

Të kërkojnë shpërblimin e dëmit dhe të pranohet si paditës civil në procesin penal; të ankohet në gjykatë ndaj prokurorit/gjyqtarit



Viktima të dhunës seksuale

► Kodi Penal në Seksionin «Krime Seksuale» përcakton si «dhunë seksuale»:

Ushtrimi i dhunës seksuale, nëpërmjet kryerjes së veprimeve me natyrë seksuale në trupin e një personi tjetër me objekte, përbën vepër penale dhe dënohet me **burgim nga tre deri në shtatë vjet.**

Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim, kundër disa personave, më shumë se një herë, ose kundër fëmijëve të moshës katërmëdhjetë deri në tetëmbëdhjetë vjeç dënohet me burgim nga **pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.**

Kur kjo vepër kryhet ndaj një të mituri që nuk ka arritur moshën katërmëdhjetë vjeç apo një të mituri që nuk ka arritur pjekurinë seksuale, pavarësisht nëse kryhet me dhunë apo jo, dënohet me **burgim jo më pak se njëzet vjet.**

Kur kjo vepër ka sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e të dëmtuarit dënohet me burgim **jo më pak se njëzet e pesë vjet.**

Viktima të dhunës seksuale

► Kodi Penal në Seksionin «Krime Seksuale» përcakton format e abuzimit seksual:

- ✓ Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur;
- ✓ Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me dhunë me të miturtë moshës 14-18 vjeç;
- ✓ Marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura;
- ✓ Marrëdhëniet homoseksuale me dhunë me të rritur;
- ✓ Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona të pazotë për t'u mbrojtur;
- ✓ Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me kërcënim me përdorimin e armës;
- ✓ Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale duke shpërdoruar detyrën;

Të drejtat e viktimave të abuzuar seksualisht

Të drejtën të pyeten pa vonesë nga një punonjës polici i të njëjtës gjini,

Të drejtën për t'u marrë në pyetje duke përdorur mjetet audiovizive.

Të drejtën për të mos ju përgjigjur pyetjeve private



Të drejtën për t'u përjashtuar nga shpenzimet gjyqësore dhe e drejta e viktimave për t'u kompensuar dhe dëmshpërblyer.;

Mbulim i detyrueshëm i kujdesit shëndetësor për viktimat e trafikimit.

Të drejtën për ndihmë ekonomike në shumën 3000 lek në muaj.

familje dhe abuzimit seksual


Urdhër Mbrojtje

Urdhri I lëshuar me **vendim gjykatë**, ku parashikohen masat mbrojtëse për viktimën, fëmijët dhe sipas rastit, masa për rehabilitimin e dhunuesit.



Urdhër i Menjëhershëm Mbrojtje

Urdhri i lëshuar përkohësisht me vendim gjykatë, i vlefshëm deri në lëshimin e urdhrit të mbrojtjes me vendim gjykatë.



Urdhër Paraprak Mbrojtje

Urdhri i arsyetuar që përmban **masat e menjëhershme për ndalimin e dhunës, që merren nga organet përgjegjëse për trajtimin e rasteve të dhunës në familje pranë Policisë së Shtetit**, deri në marrjen e vendimit nga gjykata.



Procedura për paraqitjen e UM



01

Afati

Kërkesë-padia për urdhër mbrojtjeje mund të paraqitet në çdo kohë para gjykatës nga ana e personave që legjitimohen për ta kërkuar atë.

02

Ndihmë e menjëhershme

Në rastet kur kërkohet ndihmë e menjëhershme, kërkesa mund të plotësohet dhe të paraqitet pranë komisariatit më të afërt të policisë.

03

Ndihmë ligjore falas


Kërkuesi asistohet nga një paraligjor/jurist/avokat që ofron ndihmën juridike dytësore.

04

Shpenzimet gjyqësore

Pas lëshimit të UMM/UM-së, shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës që ka ushtruar dhunë në familje.


**Nga pagimi i tarifave
gjqësore dhe shpenzimeve
gjqësore**



**Detyrimi për të parapaguar
tarifën e vënies në ekzekutim
të urdhrin pranë shërbimit
përmbarimor
gjqësor shtetëror,**

**Pagimi i akteve të ekspertimit
psikosocial, të interpretit të gjuhës
së shenjave, të ekspertimit mjeko-
ligjor, të ekspertimit për vlerësimin e
rrezikut të dhunës në familje ose të
ndonjë akti ekspertimi tjetër.**

Cilat janë masat që mund të vendosë gjykata përmes **UM/UMM**?



Procedura?


Organi kompetent është gjykata e juridiksionit të përgjithshëm e shkallës së parë.


Kërkesa për të lëshuar UMM nuk është kusht për lëshimin e UM.

Gjykata vendos për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes brenda 15 ditëve nga dita e regjistrimit të kërkesës.

Në rastin e kërkesës për UMM ,gjykata vendos : a) brenda 24 orëve pas parashtrimit të kërkesës të një të mituri; b) brenda 48 orëve pas parashtrimit të kërkesës të subjekteve të tjera

Vendimi i gjykatës për nxjerrjen e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes përbën titull ekzekutiv dhe nuk mund të ankimohet.





A mund të ankohe mi ndaj UM/UMM?

- Ligji parashikon të drejtën e ankimi kundër vendimit të gjykatës për lëshimin e UM dhe vërtetimin e UMM.
- Në këtë rast ankimi paraqitet **brenda 5 ditëve** nga shpallja e vendimit ose nga dita e marrjes dijeni.
- Gjykata e apelit vendos **brenda 15 ditëve** nga dita e regjistrimit të ankimit.
- Kundër vendimit të gjykatës së apelit **nuk lejohet** rekurs në Gjykatën e Lartë.
- Kundër vendimit të gjykatës që ka lëshuar urdhrin e mbrojtjes **nuk lejohet** ankimi nga viktimi.

Megjithatë, pavarësisht paraqitjes së ankimit, ligji parashikon se **paraqitja e ankimit nuk e pezullon ekzekutimin e vendimit të gjykatës për lëshimin e UMM/UM.**

Urdhëri paraprak i mbrojtjes



Kur nga kryerja e vlerësimit të riskut rezulton se **dhuna e ushtruar paraqet rrezik për jetën, shëndetin dhe lirinë e anëtarëve të familjes.**

KUR?

Strukturat përgjegjëse për trajtimin e rasteve të dhunës në familje,

KUSH?

Masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme

CFARË?

Urdhri për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme nxirret nga **titullari I strukturës përgjegjëse të Policisë së Shtetit**

SI?

Brenda 48 orëve kërkesë për vlerësimin e masave paraprake të MM dhe kërkesëpadi për lëshimin e UMM

AFATI?

Gjykata vendos brenda 48 orëve nga paraqitja e kërkesës

AFATI?

RAST PRAKTIK

Dora ka qëndruar me Anrin për rreth 4 vjet. Ata bashkëjetonin gjatë gjithë kësaj periudhë. Anri filloi të përdorte dhunë ndaj Dorës dhe më pas ai vazhdon shoqërohet me një vajzë tjetër. Ai l kërkon Dorës të largohet nga banesa ku kanë qëndruar. Dora kërkon ndihmë sipas Ligjit Për dhunën në Familje. Drejtoria për ndihmën juridike ua ka caktuar juve çështjen për këshillim.

Gjatë intervistimit me Dorën ju zbuloni faktet e mëposhtme:

1. Dora nuk ka të ardhura apo pasuri, kurse Anri fiton një shumë të konsiderueshme të ardhurash cdo muaj.
2. Dora ka prishur marrëdhëniet me familjen e saj për të bashkëjetuar me Anrin.
3. Anri refuzon të paguajë qeranë e apartamentit ku ata banonin.

Diskutoni në lidhje me pyetjet e mëposhtme:

1. A mund të kërkojë Dora mbrojtje sipas Ligjit kundër Dhunës në Familje ?
2. A mund të kërkojë ajo që Anri të paguajë qiranë e dhomës ku ata bashkëjetonin?
3. Cilat janë mjetet ligjore që mund të përdorë Dora për mbrojtje? Si do ta këshillonit ju nëse Dora iu drejtohet për ndihmë?



I e mitur ne konflikt me ligjin!



01

Çdo person **që ka mbushur moshën e përgjegjësisë penale deri nën moshën 18 vjeç**, ndaj të cilit ekziston një dyshim i arsyeshëm se ka kryer një vepër penale, është marrë si i pandehur dhe/ose është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale.

02

Për qëllime të përgjegjësisë penale për **krimet**, konsiderohet i mitur, personi i cili ka mbushur moshën **14 vjeç, por jo 18 vjeç në kohën e kryerjes së krimit**.


03

për qëllime të përgjegjësisë për **kundërvajtjet penale**, konsiderohet i mitur, personi i cili ka mbushur moshën **16 vjeç, por jo 18 vjeç** në kohën e kryerjes së kundërvajtjes penale..


04

Të drejta të veçanta


Të Miturit Në Konflikt Me Ligjin:




Të drejtat e të miturve në konflikt me ligjin




Të drejtën për ndihmë ligjore dhe psikologjike ose çdo ndihmë tjetër të duhur për përgatitjen dhe paraqitjen e mbrojtjes së tij;



Të drejtën të informohet menjëherë në formën që i përgjigjet zhvillimit individual të tij dhe të drejtën për një përkthyes falas/interpretues, në qoftë se nuk e kupton, nuk e flet gjuhën që përdoret ose përdor gjuhën e shenjave;



Të drejtën që të ketë prindin të pranishëm dhe/ose të drejtën të shoqërohet nga një person i besuar; të drejtën të mos detyrohet të dëshmojë ose të pranojë fajësinë;



Të drejtën që, në kushte të barabarta, të pyesë dëshmitarët e akuzës dhe të sigurojë paraqitjen dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve të mbrojtjes së tij; të drejtën për ndihmë nga shërbimi konsullor; të drejtën për ankim, në çdo fazë të procedimit penal apo gjatë ekzekutimit të vendimit penal.

Programi i shmangies

Të pranojë dhe të tregojë se e kupton përgjegjësinë për veprën penale dhe të pasojës së ardhur ndaj viktimës;

- Të kompensojë dëmin e shkaktuar viktimës, komunitetit dhe/ose shoqërisë;
 - T'i kërkojë falje viktimës;




- Të ndërmarrë veprime të pranueshme edhe nga viktima ose/dhe komuniteti.
- Të marrë pjesë në një procedurë ndërmjetësimi,

Të kryejë punë në interes publik;

- Të marrë pjesë në programe rehabilituese ndaj pasojave të veprës penale

Avantazhet e ndërmjetësimit



RAST PRAKTIK

Brian, i moshës rreth 16 vjeç është kapur nga policia me pretendimin se ai kishte vjedhur celularin e punëdhënësit të tij. Megjithatë celulari nuk gjurmohet prej tij. Policia e çon në stacionin e policisë dhe e mban atë të mbyllur në një dhomë vetëm. Pas disa orësh uniformat e policisë e nxjerrin nga dhoma dhe e rrahin me forcë me qëllim që Brian të tregojë se ku është celulari. Por Brian vazhdimisht mban qëndrimin që ai nuk e kishte vjedhur celularin. Ai gjithashtu vazhdon të kërkojë që të lejohet të takojë prindërit e tij, por autoritetet nuk e mundësojnë një gjë të tillë. Për shkak të frikës dhe presionit policor, Brian bën një deklaratë se e kishte vjedhur celularin dhe ia kishte shitur dikujt për 10.000 lekë. Ai vazhdon mbahet në burg deri sa të gjykohet. Nëna e tij jeton e vetme dhe nuk ka të ardhura për të paguar një avokat për Brian. Ajo bën një kërkesë për ndihmë ligjore falas dhe DNJ e kalon rastin tek ju.

Pyetje për diskutim në grupe:


A përfshihet Brian në kategorinë e të miturve në konflikt me ligjin?

A ka shkelje të të drejtave të Brian?

Si do ta kishit këshilluar ju një rast të tillë??



Çështjet kyç



FALEMINDERIT !

**PROGRAMI I TRAJNIMIT TË
PARALIGJORËVE**

***Kuptimi i ndërmjetësimit si një formë e
zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve***


TETOR 2022



Centre for Legal
Empowerment

www.cle.al

Çështjet që do të trajtohen gjatë trajnimit



Përkufizimi i ndërmjetësimit/ Përshkrim i shkurtër historik mbi ndërmjetësimin në RSH.

Avantazhet/Kritikat ndaj ndërmjetësimit/Dallimi i tij nga format e tjera të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve.

Modelet e ndërmjetësimit dhe elementët që duhet të disponojë një ndërmjetës.

Reformimi i sistemit të ndërmjetësimit me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 26/2018, “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”/ Risitë kryesore

Procedura e zhvillimit të ndërmjetësimit deri në përfundimin dhe vendosjen në ekzekutim të tij

Monitorimi i zbatimit të legjislacionit në praktikë. Gjetje dhe rekomandime/ Raste praktike studimore të zgjidhjes me ndërmjetësim.

Përkufizimi i ndërmjetësimit/ Përshkrim i shkurtër historik mbi ndërmjetësimin në RSH

- ▶ Proces konsensual për zgjidhjen e **mosmarrëveshjeve jashtëgjyqësisht**, ku palët përfshihen vullneratisht dhe bien dakord për t`ja paraqitur mosmarrëveshjen një **pale të tretë, asnjans, të besuar dhe me përvojë** (ndërmjetësit) për të ndihmuar palët të arrijnë një **zgjidhje të pranueshme të mosmarrëveshjes** dhe që **nuk bie në kundërshtim me ligjin**.
- ▶ Që prej vitit 1999 (*ligji nr. 8465, 11.03.1999*), legjislacioni shqiptar ka pësuar një zhvillim të vrullshëm. Në 23 vite janë kryer **5 ndërhyrje legjislative** (1999, 2003, 2011, 2018).
- ▶ Fillesat e ndërmjetësimit, që në drejtën zakonore shqiptare, **Kanuni i Lekë Dukagjinit**.

Pavarësisht se kanë kaluar 23 vite nga sanksionimi për herë të parë i kësaj metode, a vijon kjo e fundit të jetë një metodë “*abstrakte*” për qytetarët?

Analizë krahasuese e kuadrit ligjor për ndërmjetësimin në RSH

Ligji 8465 viti 1999

- Ndërmjetësimi **ushtrohej vetëm nga OJQ-të me mbështetje nga buxheti i Shtetit, donator, burime të tjera të ligjshme.**
- Lejohej **vetëm ndërmjetësimi pa kundërshpërblim.**
- Mungesa **kritereve për të qenë ndërmjetës, autoriteteve kompetente** për licencim, mbikëqyrje, trajnim.
- Marrëveshja e ndërmjetësimit **nuk ishte titull ekzekutiv.**
- **Vlerësohet sanksionimi i ndërmjetësimit falas!**

Ligji 9090 viti 2003

- Sanksionuar për herë të parë **ndërmjetësimi në fushën tregtare.**
- Transformohet **ndërmjetësimi si një profesion i lirë.**
- Marrëveshja e ndërmjetësimit, **titull ekzekutiv.**
- **Kritere minimale për të qenë ndërmjetës (22 vjec, arsim i lartë).**
- Mungesa **autoriteteve kompetente** për mbikëqyrje, trajnim.

Ligji 10385 viti 2011

- **Krijimi i Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve**, autoriteti kompetent për mbikëqyrje dhe trajnim.
- Licencimin e ndërmjetësve nga **Komisioni i Licencimit;**
- Parashikimi i **trajnitimit fillestar dhe vazhdues** për ndërmjetësit.
- **Ndryshohen kriteret për të qenë ndërmjetës (25 vjec, arsim i lartë, të ketë përmbushun trajnimin e formimit profesional të ndërmjetësve).**


Ligji 26 viti 2018

- **Licencimi i ndërmjetësve kompetencë ekskluzive e Ministrit të Drejtësisë.**
- **Procedurë e posaccme për mbikëqyrjen** dhe masat disiplinore për ndërmjetësit;
- **Rregullimi me ligj (jo me statut)** i organizimit dhe kompetencave të Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve (*tarifat*).
- **Zgjerimi i spektrit të çështjeve që mund të zgjidhen me ndërmjetësim** (*pronësi intelektuale; konsumator*)
- **Ndryshohen kriteret për të qenë ndërmjetës (28 vjec, eksperiencë pune 3 vite; arsim i lartë, të ketë përmbushun trajnimin e formimit profesional të ndërmjetësve).**

Avantazhet/Kritikat ndaj ndërmjetësimit



Fushat në të cilat aplikohet ndërmjetësimi



Detyrimi i gjykatave/organeve kompetente për të informuar palët mbi ndërmjetësimin

Detyrim i gjykatës, mospërbushja e të cilit ka vlerën e një shkelje procedurale e cila cënon procesin e rregullt ligjor



Detyrimi i gjykatës, vetëm informimi mbi ekzistencën e ndërmjetësimit apo adoptimi i një qasjeje proactive duke i parashtruar qytetarit avantazhet procedurale, kohore dhe financiare të ndërmjetësimit?

Dallimi i ndërmjetësimit nga format e tjera të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve

Negocimi

- Privat
- Bazohet në **vullnetin e palëve**
- Kryhet **pa praninë e një të treti**
- Palët kanë **nën kontroll procesin**
- **Proces informal**
- Bazohet tek **interesat**
- Kur ka sukses përfundon me **marrëveshje**
- Nuk ka rregullim ligjor

Ndërmjetësimi

- Privat
- Bazohet në **vullnetin e palëve**
- Kryhet **në praninë e një të treti të zgjedhur nga palët**, pa fuqi vendimmarrëse
- Palët kanë **nën kontroll procesin**
- Proces informal, **pjesërisht i strukturuar**
- Bazohet tek **interesat**
- Kur ka sukses përfundon me **marrëveshje-titull ekzekutiv**
- Rregullohet me ligjin 26/2018.
- Ngushtësisht personal, **nuk transferohet tek trashëgimtarët**.

Arbitrazi

- Privat
- Bazohet në **vullnetin e palëve**
- Kryhet në **praninë e një të treti të zgjedhur nga palët, i cili ka fuqi vendimmarrëse**
- Palët përcaktojnë rregullat e procesit por **nuk e kanë nën kontroll atë**
- **Proces më pak formal se gjyqësori**. Palët përcaktojnë vetë rregullat material dhe procedurale
- Bazohet tek **interesat dhe të drejtat**
- Kur ka sukses përfundon me dhënien e një **vendimi të detyrueshëm-titull ekzekutiv**
- Rregullohet me Kodin e Procedurës Civile

Gjyqësori

- Publik
- **Nuk kërkon vullnetin e përbashkët të palëve**
- Kryhet në praninë e një të treti **gjyqtari të caktuar me short, i cili ka fuqi vendimmarrëse**
- **Rregullat e procesit nuk përcaktohen nga palët** dhe ato nuk e kanë nën kontroll
- **Proces formal dhe i strukturuar** sipas rregullave të detyrueshme
- Bazohet tek **të drejtat**
- Përfundon me dhënien e një **vendimi të detyrueshëm-titull ekzekutiv**
- Rregullohet nga normat udhëuese të Kodeve Procedurale

Modelet e ndërmjetësimit

Ndërmjetësimi lehtësues: (Ndërmjetësi lehtëson dhe përmirëson komunikimin mes palëve në mënyrë që ata të marrin një vendim të përbashkët)- ***Përbën rrezik që palët të arrijnë në një marrëveshje përtej kuadrit ligjor?***

Ndërmjetësimi vlerësues: (Ndërmjetësi këshillon palët në konflikt mbi përfundimin që do kishte çështja nëse do të shkonte në gjykatë)- ***Përbën rrezik abuziviteti në rast anshmërie të ndërmjetësit?***

Ndërmjetësimi transformues: (Suksesi i ndërmjetësit matet nisur nga fakti nëse marrëdhënia midis palëve është përmirësuar ose jo dhe jo nëse marrëdhënia është zgjidhur apo jo)- ***A përmbushet në këtë rast detyra e ndërmjetësit?***

***Cili model ndërmjetësimi është më i përshtatshëm sipas jush?
Cili model aplikohet në Shqipëri?***

Elementët që duhet të disponojë një ndërmjetës.

Elementët formalë:

- 28 vjeç
- Eksperiencë pune 3 vite
- Arsim i lartë
- Të ketë përmbushur trajnimin e formimit profesional të ndërmjetësve dhe provimin kualifikues
- Të mos jetë i dënuar për kryerjen e një vepre penale më dashje me një vendim gjyqësor të formës së prerë.

Cilësitë/Aftësitë personale:

- Karakter të përshtatshëm:** (i artikuluar, i durueshëm, jo paragjykes, fleksibël)
- Aftësi analitike:** (Analizon situatën dhe dinamikat e konfliktit me qëllim zgjidhjen e situatës)
- Aftësi komunikuese:** (Dëgjues efektiv, inteligjent, komunikues i fortë, bindës, me imagjinatë, i mirëinformuar)
- Reputacion profesional:** (Integritet profesional, objektivitet, besueshmëri, akses në burime informative)

Reformimi i sistemit të ndërmjetësimit me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 26/2018, “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”

Risite kryesore

Licencimi i veprimtarisë së ndërmjetësit

Trajnimi i detyrueshëm i ndërmjetësit

Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve

Mbikëqyrja dhe procedimi disiplinor

Procedura e ndërmjetësimit

Reformimi i sistemit të ndërmjetësimit me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 26/2018, “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”

Risitë kryesore

▪ **Licencimi i veprimtarisë së ndërmjetësit:**

- Ndërmjetës, **person fizik** ose **juridik**.
- Pas përfundimit të **trajnitimit fillestar** dhe **provimit kualifikues**.
- **Autoriteti kompetent** Ministri i Drejtësisë.
- **Ndërmjetësit për të miturit dhe për çështjet me natyrë tregtare**, duhet të kenë kualifikimin dhe specializimin e duhur.

▪ **Heqja e licencës së ndërmjetësit:**

- **Heq dorë** me kërkesën e tij.
- **Humbet ose i kufizohet zotësia** për të vepruar.
- Dënohet me **vendim të formës së prerë për një vepër penale** të kryer me dashje.
- **Nuk e ushtron veprimtarinë si ndërmjetës** për 2 vite.
- Shkel dispozitat e **ligjit, Kodit të Etikës**.

Reformimi i sistemit të ndërmjetësimit me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 26/2018, “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”

Risite kryesore

- **Trajnimi i fillestar dhe i vazhdueshëm i ndërmjetësit**

- Ofrohet **të paktën një herë në vit** nga Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve.
- Mund të ofrohet **dhe nga institucione të arsimit të lartë të akredituara**, programi i të cilave miratohet paraprakisht nga Ministria e Drejtësisë.
- Në përfundim të trajnimit fillestar, organizohet **provimi i kualifikimit të paktën një herë në vit** nga Ministria e Drejtësisë dhe Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve.
- Ndërmjetësi ka **detyrimin për ndjekjen e trajnimit vazhdueshëm**.

Nga eksperiencia juaj, a janë të mjaftueshme dhe të plota këto trajnime? A duhen parashikuar trajnime të specializuara sipas fushës së veprimtarisë së ndërmjetësit?

Reformimi i sistemit të ndërmjetësimit me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 26/2018, “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”

Risitë kryesore

- **Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve**

- **Person juridik** i cili e ushtron veprimtarinë në mënyrë të **pavarur nga shteti**.
- **Rregullon dhe kontrollon ushtrimin e profesionit** të ndërmjetësit në RSH.
- **Hap/Mbyll degë vendore ndërmjetësimi**, në varësi të Dhomës.
- **Monitoron procesin e trajnimit** të ndërmjetësve.
- **Propozon tarifën e shpërblimit të ndërmjetësimit**, të cilat miratohen me akt të Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Financave.
- **Informon dhe ndërgjegjëson qytetarët mbi veprimtarinë e ndërmjetësimit** dhe mënyrën e kontaktimit të ndërmjetësve.

Reformimi i sistemit të ndërmjetësimit me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 26/2018, “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”

Risite kryesore

- **Mbikëqyrja dhe procedimi disiplinor**

- **Bordi Disiplinor:** 5 anëtarë (1 nga Ministri i Drejtësisë, 4 nga mbledhja e përgjithshme e ndërmjetësve)
- **Nis procedimin disiplinor mbi bazën e një ankesë të paraqitur nga** DHKN, MD, palët që kanë marrë pjesë në ndërmjetësim, organet shtetërore të përcaktuara në ligj të vecantë.
- Ankesa brenda **30 ditëve nga momenti i marrjes dijeni për shkeljen**, jo më shumë se 2 vite nga kryerja e shkeljes. Bordi Disiplinor vendos **brenda 60 ditëve nga depozitimi ankesës**.
- Procedimi disiplinor për **sjellje joprofesionale (ligj, kodi etikës) shëbime të papërshtatshme profesionale**.
- **Masat disiplinore:** Vërejtje me shkrim; trajnim vazhdues shtesë; gjobë-300.000 lekë; pezullim i përkohshëm i aktivitetit; rekomandim Ministrit të Drejtësisë për heqjen e licencës.
- **Afati për shuarjen e masave (1-5 vite).**

Reformimi i sistemit të ndërmjetësimit me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 26/2018, “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”

Risitë kryesore


- **Procedura e ndërmjetësimit (Parimet kryesore)**

Ruajtja e
konfidencialitetit

Ruajtja e sekretit
profesional

Deklarimi i cdo
konflikti të
mundshëm
interesi

Përrjashtime nga parimi i konfidencialitetit



Mbrojtja e interesave publike

Është e nevojshme për shkaqe të cenimit të interesave themelore të shtetit dhe/apo interesit publik;



Mbrojtja nga dhuna

Është e nevojshme për parandalimin apo ndalimin e dhunës fizike apo psikologjike ndaj çdo personi, veçanërisht ndaj fëmijëve apo personave me aftësi të kufizuara;



Mbrojtja e personave me aftësi të kufizuara

Është e nevojshme për parandalimin apo ndalimin e keqtrajtimit, të dhunës fizike apo psikike të personave me aftësi të kufizuara;



Sigurimi i zbatimit të marrëveshjes

Nëpërmjet bërjes publike të të dhënave dhe/apo marrëveshjes së ndërmjetësimit sigurohet zbatimi i kësaj marrëveshjeje

Reformimi i sistemit të ndërmjetësimit me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 26/2018, “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”

Risitë kryesore

▪ Procedura e ndërmjetësimit:

Fillimi i procedurës:

- Data e paraqitjes së ftesës nga njëra palë;
- Data e referimit të çështjes nga gjykata.
- Nëse pala tjetër nuk përgjigjet brenda 30 ditëve, mospranim i ftesës për ndërmjetësim.

Caktimi i ndërmjetësit:

- Palët caktojnë bashkërisht nga lista e ndërmjetësve të licencuar 1 ose më shumë ndërmjetës;
- Ligji nuk e kushtëzon kompetencën tokësore të ndërmjetësit.

Nënshkrimi i marrëveshjes për procesin e ndërmjetësimit (*si rregull me shkrim*)

- Gjeneralitetet;
- Objekti mosmarrëveshjes;
- Parimet e ndërmjetësimit;
- Vendi i ndërmjetësimit;
- Shpenzimet dhe shpërblimi ndërmjetësit;
- Mungesa e një marrëveshje nuk passjell mosrealizimin e procedurës.

Reformimi i sistemit të ndërmjetësimit me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 26/2018, “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”

Risitë kryesore

▪ Procedura e ndërmjetësimit: Zgjidhja e mosmarrëveshjes dhe ekzekutimi

Aktmarrëveshja (forma)

- Në formë të shkruar ose verbale.
- Në formë të shkruar detyrimisht për ndërmjetësimin mbi detyrimet në të holla.
- Hartohet në 3 kopje

Aktmarrëveshja (elementët)

- Palët;
- Përshkrimi mosmarrëveshjes;
- Detyrimet, mënyra dhe afati i përmbushjes së tyre;
- Nënshkrimi i palëve dhe i ndërmjetësit.

Aktmarrëveshja (ekzekutimi)

- Titull ekzekutiv, ngarkohet shërbimi përmbartimor për ekzekutimin e saj;
- Nëse ccështja në process gjyqësor, gjykata vendos zgjidhjen me pajtim të ccështjes civile ose pushimin e ccështjes penale;
- Pavlefshmëria është e vetmja formë që mund të kundërshtohet aktmarrëveshja nga gjykata.

Pavlefshmëria e ndërmjetësimit?

1. Realizohet nga persona që nuk janë ndërmjetës të licencuar dhe të regjistruar sipas këtij ligji?
 2. Mosmarrëveshja, sipas ligjit, duhet zgjidhur vetëm në rrugë gjyqësore;
 3. Përmban detyrime të vlerësueshme në të holla dhe nuk formulohet me shkrim;
 4. Përmban detyrime për subjekte që nuk kanë marrë pjesë në ndërmjetësim;
 5. Ka simulim dhe, për konfliktin real, ka shkaqe pavlefshmërie
-

Raport mbi rezultatet e monitorimit të zbatimit të legjislacionit për ndërmjetësimin (ALTRI/OSFA Qershor 2020)

- **Niveli i njohurive të të anketuarve në lidhje me ndërmjetësimin është i ulët**, pasi afërsisht 2/3 e të anketuarve janë shprehur se nuk kanë informacion në lidhje me këtë mënyrë të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve;
- **Informacioni në lidhje me ndërmjetësimin merret kryesisht përmes medias/internetit** dhe në një masë më të vogël nga gjykata që shqyrton çështjen;
- Në pothuajse 2/3 e procesve gjyqësore të monitoruara **gjyqtarët nuk kanë përmendur mundësinë e zgjidhjes së mosmarrëveshjes me ndërmjetësim;**
- Kur gjyqtarët informojnë palët në lidhje me ndërmjetësimin, **në shumicën e rasteve mjaftohen vetëm duke e përmendur këtë mundësi**, pa adoptuar një qasje proaktive në parashtrimin e avantazheve procedurale, kohore dhe financiare të ndërmjetësimit;
- Pothuaj **75% e të anketuarve nuk do të zgjidhnin ndërmjetësimin edhe nëse i sugjerohej nga gjyqtari** ndërkohë që edhe gjyqtarët vërejnë një tendencë nga palët për refuzuar mundësinë e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve me ndërmjetësim, në rastet kur ato njoftohen/udhëzohen nga gjyqtarët lidhur me këtë procedure.

Raport mbi rezultatet e monitorimit të zbatimit të legjislacionit për ndërmjetësimin (ALTRI/OSFA Qershor 2020)

- Pjesa më e madhe e të anketuarve mendojnë se ndërmjetësimi është një mekanizëm që vetëm do të zvarrisë procesin e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, ose do të ketë kosto të shtuara, dhe një pjesë e tyre **nuk kanë besim në profesionalizmin, konfidencialitetin si dhe paanësinë e ndërmjetësit;**
- Gjyqtarët, prokurorët dhe ndërmjetësit konstatojnë *mungesë të besimit nga palët tek fuqia zbatuese e marrëveshjes së ndërmjetësimit* dhe nëse pala tjetër do i qëndrojë kësaj marrëveshjeje, çfarë mund të sjellë si pasojë zgjatjen e procesit gjyqësor dhe shpenzime shtesë për palën;
- Të anketuarit, gjyqtarët dhe prokurorët e intervistuar shprehen gjithashtu se në disa raste **avokatët u këshillojnë palëve zgjidhjen e çështjeve në rrugë gjyqësore** me qëllim garantimin në vijimësi të ofrimit të shërbimit të mbrojtjes ligjore;
- **Niveli profesional i ndërmjetësve vlerësohet jo në nivelet e duhura** dhe mungojnë trajnimet vazhduese të ndërmjetësve dhe promovimi i duhur nga DHKN;

Raport mbi rezultatet e monitorimit të zbatimit të legjislacionit për ndërmjetësimin (ALTRI/OSFA Qershor 2020)

- Kostot e ndërmjetësimit konsiderohen nga gjyqtarët dhe prokurorët si të papërbalueshme, kryesisht nga ana e familjarëve të të miturve në konflikt me ligjin. Individët e anketuar që kanë marrë pjesë në një proces ndërmjetësimi shprehen vetëm pjesërisht të kënaqur me tarifat. **Mungesa e një tavani, lehtësimit ose subvencionimi të tarifave për grupet në nevojë mund të përbëjë një faktor që ndikon në mospërzgjedhjen e ndërmjetësimit** si mënyrë e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve;
- **Ligji nuk parashikon mundësi të përjashtimit nga detyrimi i pagimit të tarifës së shërbimit** ose lehtësimit të kësaj tarife në procedurën e ndërmjetësimit në rastet e të miturit në konflikt me ligjin, apo kategoritë përfituese të ligjit për ndihmën juriidike i ngritur si shqetësim edhe nga gjyqtarët dhe prokurorët.
- **Tarifat e shërbimit nuk janë të publikuara në faqen zyrtare të DHKN apo Ministrisë së Drejtësisë** dhe nuk janë të aksesueshme nga qytetarët.

Raport mbi rezultatet e monitorimit të zbatimit të legjislacionit për ndërmjetësimin (ALTRI/OSFA Qershor 2020)

- Gjyqtarët dhe prokurorët e konsiderojnë përgjithësisht referimin e palëve tek ndërmjetësimi **si një veprim paragjykues ndaj çështjes, që cënon të drejtën e palëve për t'iu drejtuar gjykatës.**
- **Nuk është siguruar profilizimi i ndërmjetësve** sipas fushave të së drejtës ku ofrohet ndërmjetësimi duke i dhënë prioritet profilizimit të ndërmjetësve që trajtojnë çështjet e të miturve në konflikt me ligjin;
- **Shpërndarja gjeografike e ndërmjetësive që ofrojnë shërbimin e ndërmjetësimit është problematike, pasi shumica** e ndërmjetësve të licencuar e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Tiranë duke sjellë kështu kufizim të aksesit të qytetarëve në këtë shërbim;
- **Individët e anketuar që e kanë përdorur shërbimin e ndërmjetësimit, shprehen shumë të kënaqur ose të kënaqur me këtë mënyrë zgjidhjeje të mosmarrëveshjeve** dhe me mënyrën e ofrimit të shërbimeve nga ndërmjetësi;
- **Në 83% të rasteve, qytetarët e anketuar që i janë nënshtruar një procesi ndërmjetësimi do të zgjidhnin sërish ndërmjetësimin** si mënyrë e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të tyre.

REKOMANDIME

- **Ndërmarrja e fushatave të gjera ndërgjegjësuere** dhe promovuese për individët e të gjitha moshave, niveleve arsimore, si në zonat rurale dhe ato urbane.
- Parashikimi në ligj i **referimit të detyrueshëm nga gjyqtari/prokurori për realizimin e një takimi paraprak me ndërmjetësin**, përpara se të nisë shqyrtimi gjyqësor, sidomos për kategori të vecanta çështjesh gjyqësore, veçanërisht në rastet e padive me vlerë të vogël dhe proceset gjyqësore me subjekt të mitur në konflikt me ligjin;
- Parashikimi i mekanizmave për **mbikqyrjen nga KLGJ dhe KLP të zbatimit të detyrimit ligjor për referimin nga gjyqtarët dhe prokurorët** duke e përfshirë në sistemin e vlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve;
- **Publikimi nga MD dhe DHKN i udhëzimit të përbashkët midis Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Financave** për tarifatat e shërbimit të ndërmjetësimit si dhe parashikimi ligjor i mundësisë së përjashtimit nga tarifa ose reduktimit të tarifës për subjekte që u përkasin grupeve në nevojë;

REKOMANDIME

- **Organizimi i trajnimeve nga Shkolla e Magjistraturës** me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit dhe kapaciteteve të gjyqtarëve dhe prokurorëve në lidhje me ndërmjetësimin
- Ndërmarrja e **hapave konkrete për profilizimin e ndërmjetësve**, me fokus të veçantë ndërmjetësit që angazhohen në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me subjekte të mitur në konflikt me ligjin;
- **Zhvillimi në mënyrë periodike i trajnimeve të ndërmjetësve** me qëllim rritjen e kapaciteteve të tyre profesionale, prezantimin me metodat efektive bashkëkohore, në funksion të rritjes së besimit të qytetarëve tek kjo mënyrë e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve;
- **Kontrolli periodik i ushtrimit të veprimtarisë dhe mënyrës së ofrimit të shërbimeve të ndërmjetësimit** nga ndërmjetësit me integritet dhe profesionalizëm përmes inspektimeve nga
- **Vlerësimi i mundësisë së përfshirjes së klinikave të ligjit në fakultete dhe pedagogëve ndërmjetës** në proceset e ndërmjetësimit të referuara nga gjykata ose me nismën e palëve, me qëllim rritjen e profesionalizimit dhe besueshmërisë në ofrimin e këtij shërbimi ndaj qytetarëve.

Rast praktik

Në tetor 2019, para gjykatës së shkallës së parë paraqiten dy vëllezër në konflikt për gardhin ndarës të shtëpive të tyre. Në seancën e dytë gjyqësore, të dy vëllezërit shprehen se duan ta zgjidhin konfliktin e tyre me mirëkuptim.

Gjyqtari merr vendim të ndërmjetëm dhe vendos që të dyja palët të shkojnë tek noteri të bëjnë marrëveshjen për zgjidhjen me mirekuptim dhe ta paraqesin në seancën e ardhshme gjyqësore.

- A është në përputhje me ligjin ky vendim? Cfarë duhet të bënte gjyqtari në këtë rast? A jemi përpara rasteve të ndërmjetësimit të detyrueshëm?

FALEMINDERIT !

**PROGRAMI I TRAJNIMIT TË
PARALIGJORËVE**

***Ligji për të drejtën e informimit dhe mënyra e
hartimit të shkresave zyrtare***


TETOR 2022



Centre for Legal
Empowerment

www.cle.al

Çështjet që do të trajtohen gjatë trajnimit



Ligji nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”

Njohja me informacionin publik-kërkesa për informim
(*procedurat dhe afati*)

Kufizimi i së drejtës për informim/ Procedurat për
dërgimin dhe shqyrtimin e ankesave

Mënyra e hartimit të shkresave drejtuar institucioneve të
administratës publike (*formatet standarde të miratuara*)

Ruajta e komunikimit shkresor. Procedurat që ndiqen
nga organet e administratës shtetërore.

E drejta e informimit-Parimet themelore

► Neni 6 i Kodit të Procedurave Administrative (*Parimi i informimit*)

-Çdo person ka të drejtë të kërkojë informacion publik, që ka të bëjë me veprimtarinë e organit publik, **pa qenë i detyruar të shpjegojë motivet**, në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon të drejtën e informimit.

-Në rastet **kur informacioni i kërkuar refuzohet, organi publik merr vendim të arsyetuar me shkrim**, i cili përmban edhe udhëzimet për ushtrimin e së drejtës për ankim dhe i njoftohet menjëherë palëve në proces.

□ Neni 7 i Kodit të Procedurave Administrative (*Parimi i mbrojtjes së sekretit shtetëror*)

-Çdo nëpunës publik, si dhe çdo person që merr pjesë ose thirret për pjesëmarrje në një procedurë administrative, është i detyruar **të mos përhapë të dhëna që i janë bërë të ditura gjatë procedurës administrative, kur ato përbëjnë “Sekret shtetëror”**, sipas legjislacionit në fuqi.

E drejta e informimit-Parimet themelore

► Neni 9 i Kodit të Procedurave Administrative- *(Parimi i mbrojtjes së të dhënave)*

-Organi publik ka detyrimin që gjatë përpunimit të ligjshëm e të drejtë të të dhënave personale, të të dhënave që lidhen me veprimtarinë tregtare ose profesionale, me të cilat njihet gjatë procedurës administrative dhe që mbrohen sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, të ndërmarrë **masa lidhur me mbrojtjen, ruajtjen, mospërhapjen, si dhe konfidencialitetin e tyre**. Detyrimi për mbrojtjen, ruajtjen, mos-përhapjen, si dhe konfidencialitetin shtrihet edhe mbi nëpunësin publik, gjatë edhe pas mbarimit të ushtrimit të detyrës.

□ Neni 10 i Kodit të Procedurave Administrative- *(Parimi i dhënies së ndihmës aktive)*

- Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre. Organi publik promovon mundësinë e palës për të aksesuar autoritetin publik në mënyrë elektronike.

E drejta e informimit-Parimet themelore

► Neni 19-Parimi i mospagimit në procedurat administrative

-Procedura administrative është pa pagesë, përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe. Tarifa për zhvillimin e një procedure administrative nuk mund të jetë më e madhe se kostoja mesatare e nevojshme për zhvillimin e procedurës, përveçse kur parashikohet ndryshe në ligj. Organi publik që zhvillon procedurën nuk kërkon pagesën e tarifave edhe në rastet kur kjo parashikohet me ligj, kur palët janë në pamundësi për të paguar. Kategoritë që janë në kushte pamundësie përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. **Lëshimi i kopjeve të dokumenteve bëhet kundrejt një pagese, që përcaktohet në vendimin e organit publik dhe në çdo rast nuk kalon koston e riprodhimit të tyre.**

□ Neni 13- Ligji për të drejtën e informimit-Kostoja e shërbimit dhe e riprodhimit

-Shërbimet e administratës publike janë pa pagesë. Nëse institucioni ka të miratuar tarifa kundrejt shërbimit dhe riprodhimit të informacionit atëherë qytetari paguan koston. Kostoja e riprodhimit nuk mund të jetë më e lartë se kostoja e materialit. **Qytetarët kategori përfituese nga ligji për ndihmën juridike e përfitojnë informacionin falas.**

Ligji nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”

- Kategoritë e informacionit që bëhet publik
(në faqen zyrtare të institucionit/autoritetit publik)

Është detyrim i çdo autoriteti publik përcaktimi i një **Koordinatori për të Drejtën e Informimit** i cili ka Asistues/Referues dhe monitorues të të gjithë procedurës deri në kthimin e përgjigjes. Të dhënat e Koordinatorit dhe kontaktet e tij bëhen publike nga ana e institucionit.




Ligji nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”

- Kategoritë e informacionit që mund të kufizohet:

E drejta e informimit kufizohet në rast se është e **domosdoshme, proporcionale** dhe nëse dhënia e informacionit **shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë.**

Nëse **kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuessit.** Autoriteti publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim



Ligji nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”-Procedura e kërkesës për informim

Forma e kërkesës-
Gjithmonë me shkrim

Dërgohet dorazi ose me
postë (Identiteti dhe
nënshkrimi i personit)

Kërkesa i përcillet
Koordinatorit i cili
regjistron çdo kërkesë
me një numër rendor

Kërkesa duhet të
përmbajë:
Emër/Mbiemër/
Adresë/ Përshkrimin e
informacionit

Kërkesa duhet të
përmbajë:Formatin në
të cilin kërkohet
informacioni/çdo të
dhënë tjetër që
gjykohet nga kërkuesi

Ligji nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”-Trajtimi i kërkesës për informim

- **Saktësimi i kërkesës për informim:**

Nëse autoriteti publik është i paqartë për përmbajtjen dhe natyrën e kërkesës kontakton menjëherë me kërkuesin **jo më vonë se 48 orë** nga data e paraqitjes së kërkesës.

- **Trajtimi i kërkesës për informim:**

Autoriteti publik trajton kërkesës për informim dhe **brenda 10 ditëve kalendarike** nga data e dorëzimit të kërkesës informon kërkuesin dhe autoritetin kompetent (*nëse ka*).

Autoriteti kompetent, i kthen përgjigje qytetarit **jo më vonë se 15 ditë pune nga dita e mbëritjes së kërkesës në autoritetin e parë.**

Afati mund të zgjatet dhe 5 ditë pune për arsye të ligjshme (*dosje voluminoze në process/raport mjekoligjor/nevoja për konsultim mes institucioneve etj.*

Ligji nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”-Procedurat në rast të mosrespektimit të afatit ligjor

- **Organi kompetent- Komisioneri për të Drejtën e Informimin dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale- Formular TIP ankese i publikuar në faqen zyrtare të Komisionerit**

Format tip ankese për moskthimin e përgjigjes brenda afatit nga autoriteti

Format tip ankese për shkeljen e procedurave të njoftimit dhe konsultimit publik

Format tip ankese për publikimin e të dhënave personale nga autoriteti

Ligji nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”-Procedurat në rast të mosrespektimit të procedurës

- **Organi kompetent- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale- Formular TIP ankese i publikuar në faqen zyrtare të Komisionerit**
- ▶ Ankimi administrativ pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit bëhet **brenda 30 ditëve pune** nga dita kur: **ankuesi ka marrë njoftim për refuzimin e informacionit/ka kaluar afati i parashikuar në këtë ligj** për dhënien e informacionit.
- ▶ Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale merr **vendim për ankesën brenda 15 ditëve pune** nga dita kur është dorëzuar ankimi.
- ▶ Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale vendos **mospranimin e ankesës** kur: ka kaluar afati; ankimi nuk paraqitet në formë shkresore; nuk tregohet emri dhe adresa e ankuesit;
- ▶ Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale **vendos pranimin e ankesës dhe urdhërimin e autoritetit publik** për të dhënë informacionin e kërkuar, në mënyrë të plotë ose të pjesshme; afatin, brenda të cilit Autoriteti Publik duhet të zbatojë urdhrin.


Ligji nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”-Sanksionet në rast të mosrespektimit të procedurës

- Refuzimi i dhënies së informacionit, në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji, dënohet me 150 000 deri në 300 000 lekë;
- Mosregjistrimi i kërkesës për informim, mosçaktimi i një numri rendor për të dhe mosdhënia e të dhënave të kontaktit të koordinatorit për të drejtën e informimit, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 11, të këtij ligji, dënohet me 150 000 deri në 300 000 lekë;
- Mosdërgimi i kërkesës për informim te një autoritet tjetër publik, brenda afatit të parashikuar në pikën 2, të nenit 12, të këtij ligji, dënohet me 150 000 deri në 300 000 lekë;
- Refuzimi i paarsyetuar i preferencës së kërkuesit për mënyrën e dhënies së informacionit, në kundërshtim me parashikimet e pikës 4, të nenit 14, të këtij ligji, dënohet me 25 000 deri në 50 000 lekë;
- **Titullari i institucionit, Koordinatori për të Drejtën e Informimit, çdo nëpunës i autoritetit publik kompetent për trajtimin e rastit ka përgjegjësi administrative sipas nenit 19 të ligjit.**

Mënyra e hartimit të shkresave drejtuar institucioneve të administratës publike

- ▶ Formatet standarde të miratuara për konceptimin dhe hartimin e një shkrese zyrtare gjenden të publikuara në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave.
- ▶ Këto formate duhet të merren në konsideratë edhe nga kërkuesi, në momentin e hartimit të një kërkesë shkresore drejtuar institucioneve të administratës publike.
- ▶ Baza ligjore: Kodi i Procedurave Administrative; L I G J nr.9154, datë 6.11.2003, «PËR ARKIVAT» dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

Mënyra e hartimit të shkresave drejtuar institucioneve të administratës publike-Etapat e komunikimit me shkrim



Mënyra e hartimit të shkresave drejtuar institucioneve të administratës publike-Elementët përmbajtës të një shkrese

- ▶ **Data /Qyteti**, më____.____.201_
- ▶ **Dërguesi**: Gjeneralitet e plota të dërguesit. **Adresa e plotë dhe e saktë** e dërguesit. **Adresa elektronike** dhe **numri i celularit** të dërguesit.
- ▶ **Lënda**: Shënohet shkurtimi përmbajtësor i dokumentit
- ▶ **Emërtimi i plotë në rasën dhanore, me gërma kapitale, i institucionit të cilit i dërgohet kërkesa**. Adresa e plotë dhe e saktë e institucionit. *(I nderuar)*
- ▶ **Hyrja e shkresës** (përmbajtja shkurtimisht e qëllimit të kërkesës)
- ▶ **Zhvillimi** (parashtrimi shkurtimisht i rrethanave të çështjes dhe dhënia e provave/fakteve/afateve)
- ▶ **Citimi i bazës ligjore ku mbështetet kërkesa/ankesa** *(citimi në çdo rast i ligjit për të drejtën e informimit)*
- ▶ **Mbyllja** (kërkesa drejtuar institucionit)
- ▶ **Dokumentacioni bashkëlidhur** (të citohet në shkresë data, nr. prot., dhe emërtimi i dokumentit që shoqëron kërkesën)
- ▶ Duke ju falënderuar, **Emër/Mbiemër i dërguesit**
- ▶ **Nënshkrimi në cdo faqe** i kërkesës.
- ▶ Dokumentet të përpilohen me shkrim **Times Neë Roman, me madhësi 12** dhe **hapësira midis rreshtave të jetë 1.15**, si dhe në anësore të lihen 3 cm bosh, ndërsa në krye e në fund të faqes nga 2 cm

Administrimi i shkresave të ardhura nga kërkuesi

Sipas shkallës së klasifikimit të informacionit (*Të pa klasifikuara/Të klasifikuara (tepër secret/sekret/konfidencial)*)

Sipas rëndësisë: Dokumenta që krijojnë praktika/ Dokumenta të ardhura për njoftim

Sipas afatit të ruajtjes: Dokumenta me afat ruajtje përgjithmonë (RHK). Dokumente me afat ruajtje të përkohshme (5,10-75 vjet)


Rruget e suksesit ne komunikimin me shkrim




I kuptueshëm: Fjalitë nuk duhet të jenë të ngatërruara, duhet të jenë të kuptueshme lehtësisht. Fjalitë të jenë të shkurtra, koncize dhe që ndikojnë në qartësinë e shkrimit.



I qartë: Fjalitë nuk duhet të lënë vend për dyshime ose dilema. Nëse në tekst nuk ka qartësi nuk kuptohet se çfarë është dashur të thuhet.



I thjeshtë: Komunikimi me shkrim duhet të jetë i thjeshtë dhe i natyrshëm ndaj dhe fenomeni që trajtojmë duhet të jetë larg zbukurimit, falsitetit, ndjenjave dhe mendimeve.



I rrjedhshëm: Shkrija me njëra tjetrën e fjalëve, fjalive dhe paragrafëve, përshtatshmëria ndërmjet tyre mundëson rrjedhshmërinë e shkrimit. *(Të përdoren shprehjet: gjithashtu, për sa më sipër, ju bëjmë me dije dhe nota falënderuese në fund të shkresës)*



Interesant: Përshkrimi sipas një stili individual të të gjithë përmbajtjes së kërkesës që nu ngjan me të tjerët dhe shpreh një individualitet mendimi dhe kërkesë.

Pyetje

Nëse një kërkesë është e hartuar kundrejt standardeve, ndërkohë informacioni në përmbajtje lë vend për një interpretim ndryshe të kërkesës kundrejt legjilacionit. (*Ndihmë juridike dytësore/Avokat kryesisht*)- Procedura që duhet të ndjekë institucioni

Në rast se qytetari nuk merr një përgjigje brenda afatit. Procedura që duhet të ndiqet

Në rast se qytetarit i refuzohet dhënia e informacionit-Procedura që duhet të ndiqet

Një viktimë e diskriminimit i drejtohet Qendrës Shëndetësore për përcjelljen e një kopje të kartelës personale. A përjashtohet nga pagesa e tarifave të vendosura nga Ministria përkatëse?

FALEMINDERIT !